

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6860
E martë, 28 mars 2023
çmimi 0.40 €

Kurti: Serbia duhet të ballafaqohet me të kaluarën e saj kriminale në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

"MARSHI PËR DREJTËSI" NË MBËSHTETJE TË ISH-KRERËVE TË UÇK-së PO MERR PËRKRAHJE TË MADHE

FAQE 4-5



Këtë të diel në Prishtinë platforma "Liria ka emër" organizon marsh qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj të cilët po mbahen në Hagë. "Marshi

për drejtësi" do të nisë nga sheshi "Zahir Pajaziti" dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit "Skënderbeu". Deri më sot "Marshi për drejtësi" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së ka marrë

përkrahje të madhe në vend. Këtij marshi i kanë dhënë përkrahje disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe disa oda ekonomike

SHKUPI DHE TIRANA SHPRESOJNË QË DERI MË 2030 TË BËHEN PJESË E BE-së



SHOQËRIA CIVILE ADRESON SHQETËSIMET NË RAPORT ME INSTITUCIONIN E PROKURORIT TË SHTETIT


FAQE 6



OPINION

"HILJA" E
PROKURORËVE TË
SPECIALES,
ISH-UDHËHEQËSIT
E UÇK-SË PO E
CLINTONIN JO

F. 6



Shkruan Astrit GASHI

AKTUALE



VRITET ROJA E SIGURISË
SI PASOJË E SULMIT ME ARMË
NDAJ "TOP CHANNEL"-it

F. 2

KURTI VIZITON SHTËPINË-MUZE
TË FAMILJES QERKEZI, PRITET
NGA NËNË FERDONIJA

F. 3

EKONOMI



KMDLNJ: PASI RRYMA
U SHTRENJTUA, U HARRUA
TATIMI NË PRONË

F. 8

KOMPANIA E VETURAVE "VOLVO"
SË SHPEJTI DO TA HAPË DEGËN
E RE NË KOSOVË

F. 8

SPORT



KOK-u I DËRGON MUNDËSIT NË
REHABILITIM PAS TRAUMAVE TË
PËSUARA NGA TËRMETI NË TURQI

F. 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vritet roja e sigurisë si pasojë e sulmit me armë ndaj “Top Channel”-it

TIRANË, 27 MARS - Ndërtesa e “Top Channel”-it, një prej televizioneve kombëtare në Shqipëri, është sulmuar me breshëri kallashnikovi, duke lënë të vdekur rojën e sigurisë. Viktima është P. K., 60-vjeçar. Policia e Shqipërisë ka bërë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 1:00 të mëngjesit të së hënës. Sipas zyrtarëve policorë, tashmë janë krijuar disa pika kontrolli për kapjen e autorëve, por deri tani nuk ka asnjë të arrestuar.

Disa orë më vonë është gjetur një makinë e djegur, e cila dyshohet se iu përket autorëve të aktit. Brenda saj janë gjetur dy armë automatike.

Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Bledi Çuçi, ka shkruar në “Facebook” se Policia e Shtetit është maksimalisht e përkushtuar për të zbardhur këtë ngjarje të rëndë dhe për t’i vënë para drejtësisë autorët.

Sulmi ndaj ndërtesës së “Top Channel”-it është dënua edhe nga presidenti i shtetit, Bajram Begaj, kryeministri Edi Rama, kryeparlamentarja Lindita Nikolla, krerët e partive opozitare, Enkelejd Alibeaj dhe Ilir Meta.

Lidhur me këtë rast ka reaguar edhe Autoriteti i Medieve Audiovizive (AMA). “Goditja e një mjedisi mediatik është një goditje ndaj demokracisë, ndaj lirisë së fjalës dhe mendimit. AMA shpreh ngushëllimet për familjen e punonjësit që humbi jetën nga ky agresion i papranueshëm dhe qëndron në krah të të gjithë ekipit të televizionit në këto momente të vështira”, është thënë në këtë reagim.

Të hënën ka reaguar edhe Qendra Evropiane për Shtyp dhe Lirinë e Medies.

Ambasada Amerikane në Tiranë dhe Zyra e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim



në Evropë (OSBE) kanë sigurisë dhe kanë kërkuar që shprehur ngushëllime për ngjarja të hetohet dhe të humbjen e jetës së rojës së zbardhet sa më shpejt. I ndjeri

është thënë se ka nisur të punojë në këtë media gjashtë muaj më parë.

Ukraina: Kontrollimi i Bahmutit është ‘nevojë ushtarake’

KIEV, 27 MARS - Komandanti i forcave tokësore të Ukrainës, Oleksandr Syrskyi, ka thënë të hënën se trupat ushtarake janë duke vazhduar t’i zbrapsin sulmet e ashpra ruse në Bahmut dhe se kontrollimi i këtij qyteti përbën “nevojë ushtarake”.

Ushtria ukrainase ka thënë se koloneli Syrskyi i ka bërë këto deklarata në një vizitë në linjën e frontit në lindje ku ka tentuar “të zgjidhë çështje problematike që parandalojnë ekzekutimin efektiv të detyrave ushtarake” dhe të marrë “vendime operacionale që kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve për ta luftuar dëmin e armikut”.

Në deklaratë nuk janë dhënë detaje për vendin e saktë të vizitës, mirëpo komentet e Syrskyit kanë dhënë shenja se Ukraina mëton të luftojë për Bahmutin pavarësisht numrit të madh të trupave atje. “Faza më intensive e betejës për Bahmutin është duke vazhduar. Situata



vazhdon të jetë e vështirë. Armiku është duke u përballur me humbje të mëdha të burimeve njerëzore, armëve dhe pajisjeve ushtarake, mirëpo

vazhdon të kryejë sulme”, ka thënë ai.

Duke vlerësuar qëndrueshmërinë e forcave ukrainase në kushte “jashtëzakonisht të vështira”, ai ka

thënë se “mbrojtja e Bahmutit është nevojë ushtarake”. “Ne jemi duke kalkuluar të gjithë skenarët në të ardhmen dhe do të reagojmë në mënyrë adekuate

për situatën aktuale”.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, e ka vizituar Bahmutin javën e kaluar dhe u ka dhënë medalje trupave që janë duke luftuar për atë zonë.

Të shtunën komandanti i përgjithshëm, Valery Zaluzhnyi, ka thënë se situata rreth Bahmutit është duke u “stabilizuar”.

Moska e konsideron zotërimin e këtij qyteti si pikë kyçe për kontrollim të rajonit lindor të Donbasit.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus, Vladimir Putin, e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Grevat bllokojnë transportin publik në Gjermani

Berlin, 27 mars - Rrjeti i transportit në Gjermani ka qenë i bllokuar të hënën për shkak të grevave të dy sindikatave më të mëdha të punëtorëve në këtë shtet.

Stafi i aeroporteve, porteve detare, hekurudhave, autobusëve dhe metrove ka nisur grevën 24-orëshe në minutat e parë të së hënës.

Sindikatat janë duke kërkuar paga më të mëdha ashtu që punëtorët të përballen më lehtë me rritjen e çmimeve.

Deri më tani janë mbajtur disa greva më të vogla në Gjermani, mirëpo kjo e së hënës konsiderohet më e madhja në dekada.

Sindikata Verdi përfaqëson rreth 2.5 milionë punëtorë në sektorin

publik të Gjermanisë, ndërsa sindikata EVG përfaqëson rreth 230 000 punëtorë.

Verdi kërkon 10.5 për qind rritje të pagës për stafin, ndërsa EVG kërkon rritje prej 12-përqindësh. Operatori kombëtar i hekurudhave, “Deutsche Bahn”, i ka dënua planet për greva dhe i ka përshkruar “të pabaza dhe të panevojshme”.





“Marshi për drejtësi” në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së po merr përkrahje të madhe

Këtë të diel në Prishtinë platforma “Liria ka emër” organizon marsh qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj të cilët po mbahen në Hagë. “Marshi për drejtësi” do të nisë nga sheshi “Zahir Pajaziti” dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit “Skënderbeu”. Deri më sot “Marshi për drejtësi” në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së ka marrë përkrahje të madhe në vend. Këtij marshi i kanë dhënë përkrahje disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe disa oda ekonomike

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 27 MARS - Të dielën, më 2 prill, në Prishtinë, platforma “Liria ka emër” organizon marsh qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarëve të tyre. Marshi do të nisë nga sheshi “Zahir Pajaziti” dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit “Skënderbeu”. Deri më tani ky marsh ka marrë mbështetje të madhe nga disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe disa oda ekonomike. “Marshit për drejtësi” i kanë dhënë përkrahje edhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së.

Të hënën Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) i ka dhënë përkrahje marshit protestues në mbështetje të luftës së UÇK-së dhe ish-krerëve të saj. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, i ka ftuar të gjitha bizneset t’i bashkohen marshit, teksa ka thënë se ai nuk ka ngjyrë politike, por ngjyrë lirie. “Ne si Aleancë Kosovare e Biznesit i kemi dhënë mbështetjen tonë marshit të 2 prillit me emrin ‘Liria ka emër’. I ftoj të gjitha bizneset e vendit, të cilat dje ishin pjesë e luftës dhe sot janë pjesë e lirisë, t’i bashkohen kësaj proteste masive, në mënyrë që ta çojmë mesazhin se liria vërtet ka emër. Njerëzit tanë padrejtësisht mbahen në burgje të ndryshme me akuzat e pabëra, por drejtësia i qet në shesh të gjitha. Ne mburremi me luftën dhe luftëtarët tanë. Ky marsh nuk ka

ngjyrë politike, ka ngjyrë lirie, ngjyrë demokracie, drejtësie”, u shpreh Shahini. Edhe Lëvizja për Bashkim (LB) i ka dhënë përkrahje marshit “Marshojmë për drejtësi” të organizuar nga platforma “Liria ka emër”. “Duke qenë se Lëvizja për Bashkim, që nga përpjekjet e para për krijimin e kësaj gjykate, ka qenë kundër dhe e ka parë këtë institucion si përpjekje për ndryshimin e së vërtetës dhe historisë, duke qenë se padrejtësia si ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, ashtu edhe ndaj Kosovës në përgjithësi, është aq e madhe dhe e patolerueshme të institucioneve të Kosovës karshi kësaj padrejtësie, Lëvizja për Bashkim e ka parë organizimin e kësaj proteste të nevojshme dhe të domosdoshme. Prandaj Lëvizja për Bashkim do ta

mbështesë, do të marrë pjesë dhe i fton të gjithë anëtarët, simpatizantët dhe të gjithë qytetarët që ti përgjigjen kësaj ftese. Të dalim e të marshojmë të gjithë së bashku!”, është thënë në njoftimin e LB-së.

Edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë ditë më parë se kjo parti mbështet marshin për drejtësi të ftuar nga iniciativa “Liria ka emër” në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së të cilët po mbahen në Hagë.

Këtij marshi i kanë dhënë përkrahje edhe Shoqata e të Burgosurve Politikë dhe Shoqata e Pensionistëve të Kosovës. Ideatorët e platformës “Liria ka emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë thënë se ish-krerët e UÇK-së nuk janë duke u përballur me procesin gjyqësor për shkak të emrave të tyre të përveçëm, por për shkak se me emrat e tyre lidhet epoka më e ndritur e historisë sonë të re. “Përkundër se populli shqiptar ka qenë viktimë e një lufte të imponuar, ka bërë luftë të drejtë për procesin gjyqësor të pabazë, i kanë përndjekur ndër vite ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kulmi i të cilave manifestohet me procesin e Dhomave të Specializuara, në të

cilat aktualisht po mbahen ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët të tjerë”, ka thënë Eliza Hoxha.

Më tej, ajo ka shtuar se duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se drejtësia si parim është e paanshme, e plotë dhe manifeston të vërtetën, ajo beson në drejtësi, si dhe pret një epilog të drejtë të këtij procesi gjyqësor. “Gjithsesi, duhet të jemi edhe koshient se përpjekja për ta ndryshuar historinë e luftës sonë çlirimtare është përpjekje e pabazë dhe e pamundur dhe ne nuk duhet ta lejojmë që të ndodhë. Prandaj, me rastin e fillimit të procesit gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së, në emër të solidaritetit me heronjtë tanë, më 2 prill ju ftojme për një marsh solidarizimi për drejtësi. Për drejtësinë që e kërkojmë dhe kundër padrejtësive të reja”, ka thënë Hoxha.

Ideatori tjetër, Ismail Tasholli, ka thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë të drejtë për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe për lirinë e vendit tonë dhe kjo është një e vërtetë historike të cilën duhet ta ruajmë si të tillë, sepse është një e vërtetë e gjithsecilit prej nesh.

BE-ja shpreh keqardhje që Lista Serbe nuk shfrytëzoi të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje

Prishtinë, 27 mars - Bashkimi Evropian ka thënë se ndien keqardhje që Lista Serbe nuk e ka shfrytëzuar të drejtën demokratike për të marrë pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunat në veri të Kosovës. Këto zgjedhje janë caktuar të mbahen më 23 prill pas shtyrjes së tyre në dhjetor të vitit të kaluar me kërkesë të bashkësisë ndërkombëtare.

Atëbotë për zgjedhjet në veri kanë aplikuar 11 kandidatë, të cilëve u ka vlejtur certifikimi edhe për zgjedhjet e prillit. "Zgjedhjet janë gur themeli i demokracisë. BE-ja gjithmonë e ka theksuar rëndësinë e gjithpërfshirjes", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, në disa përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", duke shtuar se është shumë e rëndësishme që këto zgjedhje të mbahen në kushte paqësore.

Keqardhjen për mospjesëmarrjen e Listës Serbe në këto zgjedhje e kanë shprehur edhe vendet e Quintit - Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Italia, Franca dhe Gjermania.

Përgjatë përgatitjeve për zgjedhje në dhjetor, autoritetet e Kosovës kanë regjistruar disa incidente, siç është pengimi i hapjes së zyrave të Komisionit Qendror Zgjedhor. Sipas njohësve të çështjeve politike,

mosaplikimi i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë në këto zgjedhje - rrezikon mbarëvajtjen e gjithë procesit.

Lista Serbe, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka rikonfirmuar më 20 mars se nuk do të marrë pjesë në zgjedhje dhe do ta mbajë këtë qëndrim derisa t'i përmbushen dy kërkesa: formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe tërheqja e të gjitha njësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu i Kosovës.

Çështja e formimit të Asociacionit duhet të zgjidhet me marrëveshjen drejt normalizimit, të mbështetur nga BE-ja të cilën e kanë pranuar Kosova dhe Serbia.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar më 21 mars se "do të duhet të merremi me atë formulim sa i përket vetëmenaxhimit për komunitetin serb".

Vetëmenaxhimi për komunitetin serb në Kosovë është paraparë me marrëveshjen drejt normalizimit, por ende nuk dihet se për çfarë saktësisht bëhet fjalë.

Për Asociacionin, ndërkaq, Kosova dhe Serbia janë pajtuar në vitin 2013. Ai parashihet që serbët e Kosovës të kenë "juridiksion të plotë" në fusha të caktuara, si: planifikimi hapësinor, shëndetësia,



arsimi, zhvillimi ekonomik e kështu me radhë.

Kurti në disa raste ka përsëritur se Kosova nuk mund ta lejojë formimin e asociacioneve njëetnike sepse, sipas tij, të tillat rrezikojnë funksionalitetin e shtetit. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas një takimi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, më 18 mars në Ohër, ka thënë se zgjedhjet në veri mund të shtyhen për në qershor. "Nuk do të flas në emër të Listës Serbe.

Thjesht, duhet të flas me ata njerëz. Duhet të shoh nëse [zgjedhjet] duhet të mbahen tani apo në qershor. Do të shohim", ka thënë Vuçiqi.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale do të organizohen në katër komunat veriore - Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok pas dorëheqjeve të kryetarëve të tyre në nëntor të vitit të kaluar. Dorëheqjet e tyre, si dhe dorëheqjet kolektive të serbëve nga institucionet e Kosovës, kanë qenë

shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në RKS - Republika e Kosovës. Prej vitit 2013, kur është formuar partia Lista Serbe, ajo ka marrë mbi 90 për qind të votave nga komuniteti serb në pothuajse të gjitha zgjedhjet e Kosovës. Mirëpo misioni vëzhgues i BE-së rregullisht përmend nëpër raporte se Lista Serbe e ka "monopolizuar jetën politike në mesin e serbëve të Kosovës".

Shkupi dhe Tirana shpresojnë që deri më 2030 të bëhen pjesë e BE-së



Prishtinë, 27 mars - Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria shpresojnë që deri në vitin 2030 do të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian, por deri atëherë duhet t'i plotësojnë kriteret për anëtarësim. Kështu kanë deklaruar të hënën në Shkup ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani dhe ministrja e Punëve të Jashtme e Shqipërisë, Olta Xhaçka. Ata i vlerësuan si shumë të mira raportet në mes të dy vendeve, në veçanti ato që kanë të bëjnë me

integrimin në strukturat euroatlantike.

Një prej gjërave që Maqedonia e Veriut duhet të bëjë për ta arritur këtë, sipas Osmanit, është miratimi i ndryshimeve kushtetuese. "Është një moment i papërsëritshëm në dinamikën e imponuar evropiane të rajonit: lufta në Ukrainë, marrëveshja Kosovë - Serbi, ndërgjegjësimi i Bashkimit Evropian po krijojnë një mundësi, një shans historik që deri në vitin 2030 të gjithë të jemi brenda BE-së.

A do ta kapim këtë shans apo do të përsëritim atë që na ndodhi para 15 vjetësh në raport me Greqinë, tani mbetet në duart tona, se a do të izohemi apo do të jemi pjesë e këtij treni që do të na dërgojë drejt Brukselit, është vendim i secilit prej deputetëve në parlament, i secilit prej nesh, në emër të qytetarëve dhe shtetit tonë", tha Osmani.

Ndryshimet duhet të bëhen për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e Kushtetutës maqedonase si popull

shtetformues, ashtu siç parashihet me marrëveshjen me Bullgarinë, bazuar në atë që njihet si "propozimi francez" për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes dy shteteve për identitetin maqedonas, gjuhën dhe dallimet historike.

Ndërsa Xhaçka tha se Tirana dëshiron që dy vendet së bashku të ecin edhe në rrugën e integritit evropian ashtu siç e bën ku u anëtarësuan në NATO, por ajo tha se kjo nuk do të mund të bëhet nëse

shtetet nuk përmbushin kushtet. "Bashkërisht kemi ecur krah për krah dhe do të vazhdojmë të ecim të tillë. Por, është e rëndësishme për të gjithë aktorët politikë që ta kuptojnë se ky është një tren që s' duhet humbur, pasi është krijuar një mundësi që ne të ecim më shpejt në këtë proces. Dhe, në qoftë se dikush do të mbetet pas, ai do të mbetet në disavantazh të perspektivës dhe të mirëqenies së vendit dhe qytetarëve të vet, andaj këtë gjë nuk duhet lejuar", tha ajo.

Policia rajonale në Ferizaj shqiptoi 1 441 gjoba për kundërvajtësit

FERIZAJ, 27 MARS - Policia rajonale e Ferizajt ka ndërmarrë një sërë aktivitete për identifikimin e kundërvajtësve të ndryshëm në komunikacion me qëllim të parandalimit të aksidenteve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve policia rajonale e Ferizajt gjatë javës që shkoi,

nga data 20-26 mars, ka shqiptuar 1 441 gjoba kundërvajtëse, ndërsa përkohësisht ka hequr nga duart 22 patentëshoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion. Ndërsa janë raportuar 26 aksidente, prej tyre: aksidente me lëndime 4;

persona të lënduar 5; aksidente me dëme materiale 22.

Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se do t'i vazhdojë aktivitetet, me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor. Ajo u bënë thirrje shoferëve të kenë kujdes në komunikacion.



Drejtorja për Shëndetësi në Mitrovicë do ta formojë këshillin e pacientëve

MITROVICË, 27 MARS - Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit në mes të Drejtorisë për Shëndetësi të Mitrovicës dhe Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve në Kosovë (PRAK) i cili ka për qëllim bashkëpunimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe PRAK-ut për themelimin e Këshillit të Pacientëve në komunën e Mitrovicës.

Themelimi i Këshillit të Pacientëve është i rregulluar edhe me statutin e ri të QKMF-së, i cili është miratuar javën e kaluar në Kuvendin Komunal.

Marrëveshja është nënshkruar nga Fahri Shabani, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Ruzhdi Rexha, drejtor ekzekutiv i PRAK-ut. Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit ishin

edhe zyrtarët e DSh-së dhe QKMF-së.

Qëllimi i Këshillit të Pacientëve është të shërbejë si një mekanizëm formal i QKMF-së për përfshirjen e pacientëve në vendimmarrje në mënyrë që të punojnë së bashku me institucionet dhe stafin shëndetësor për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe komunitetin.

Drejtorja për Shëndetësi dhe QKMF-ja në procesin e themelimit dhe funksionalizimit të Këshillit të Pacientëve do të përkrahët edhe nga AQH, një organizatë tjetër partnere që vazhdimisht mbështet shëndetësinë primare të Mitrovicës.



Së shpejti reparti i Pediatriisë i Spitalit në Mitrovicë do të jetë në shërbim të qytetarëve

PRISHTINË, 27 MARS - Ministria e Shëndetësisë, Shoqata "Nënë Tereza" dhe "Jetimat e Ballkanit" nënshkruan marrëveshjen për mbështetjen financiare që i hap rrugë funksionalizimit të repartit të Pediatriisë të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, kryetari i Shoqatës Humanitare "Nënë Tereza" (Munih, Gjermani), Shaqir Gashi dhe drejtori i Shoqatës

Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, dëshmuar se kur ekziston vullneti, çdo pengesë tejkalohet, veçanërisht për shëndetin e fëmijëve.

Kjo marrëveshje krijon mundësitë që paralelisht me funksionalizimin e repartit të Pediatriisë të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, Ministria e Shëndetësisë të investojë edhe në përmirësimin e kushteve të punës për stafin shëndetësor.



Bulliqi inspekon punimet në ndërtimin e Urgjencës së Qytetit

PODUJEVË, 27 MARS - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, së bashku me drejtoreshën e Shëndetësisë, Adelina Stublla, i ka përcjellë nga afër punimet e ndërtesës së Urgjencës së Qytetit.

"Dinamikë jashtëzakonshme dhe punë cilësore, kështu mund ta përshkruajmë ecurinë e punimeve në ndërtimin e Urgjencës së Qytetit. E përgëzuar kompaninë punëkryese për punën që po

bën si dhe ofruam gjithë mbështetjen komunale për realizimin sa më të mbarë të projektit", ka thënë Bulliqi. Ai ka theksuar se Urgjenca e Qytetit do të jetë objekt i kompletuar me pajisjet më moderne shëndetësore.



Jo në emrin tim!

'Hilja' e prokurorëve të Speciales, ish-udhëheqësit e UÇK-së po e Clintonin jo



Shkruan Astrit GASHI

Jo në emrin e Kosovës! Jo akuzë nga një kriminel luftë sikur i ashtuquajtur kryesues i një komisioni të vetëquajtur "për Kosovën" në Parlamentin e Serbisë, Milovan Dreçun, i cili thotë se nga puna e këtij "komisioni", falë të dhënave të tij, është ngritur aktakuza në Gjykatën Speciale kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pse prokurorët e Gjykatës Speciale ishin selektivë në marrjen e të gjitha të dhënave nga ky njeri që ka duart me gjak. Sipas tij, edhe presidenti amerikan, Bill Clinton, duhej të paraqitej dikur në dhomën 14 të Gjykatës së Rrethit në Valjevë të Serbisë në orën 10:00 të 29 shtatorit 1999 për të dhënë shpjegime mbi akuzat se ai ka kryer krime lufte ndaj popullsisë lokale, duke shkelur kështu nenin 142 (pikat 1 dhe 2) dhe nenin 22 të Kodit Penal të

Republikës Federale të Jugosllavisë.

Këtë nen e kanë shkelur edhe të akuzuarit e Gjykatës Speciale.

Por ky komision famoz në listën e personave të akuzuar kishte edhe sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, kryeministrin britanik Tony Blair, ministrin e Jashtëm britanik Robin Cook, ministrin britanik të Mbrojtjes, George Robertson, presidentin francez Jacques Chirac, ministrin e Jashtëm francez Hubert Vedrine.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, komandanti i përgjithshëm i NATO-s në Evropë, Wesley Clark, kancelari gjerman Gerhard Schroeder, ministri i Jashtëm gjerman, Joschka Fischer dhe ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Rudolf Scharping, që të gjithë në vitin 1999 kishin pozita në vendimarrje e jo drejtuesit e luftës sonë për liri. Pra, do të duhej që cirku juaj të duket i plotë të thirren edhe këta persona në

gjykatë.

A nuk i mjaftoi Këshillit të Evropës dështimi dhjetëvjeçar i Misionit për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) i cili shpenzoi 1 miliard e 60 milionë euro për procese të montuara politike në Kosovë.

Jo gjykatës që u ngrit nga pretendimet e ngritura nga Dick Marty, nga një raport i sponsorizuar nga Dreçun dhe Rusia të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte.

Jo në emrin tim!

Me fjalë dhe fakte nuk merr vesh kjo gjykatë e montuar nga dëshmitarë të paguar!

Prandaj më 2 prill në orën 14:00 të gjithë në sheshin e paqes, në sheshin që mban emrin e misionares së paqes Nëna Tereza, për ta mbrojtur dinjitetin e shkelur nga njerëz që në emër të drejtësisë po bëjnë krim, duke kidnapuar djemtë që na sollën lirinë!

Liria ka emër. Jo në emrin tim! Jo në emër të Kosovës!

Vetëmenaxhimi është autonomi personale. Vetëmenaxhimi i bënë serbët vulëmbajtës të Kosovës



Shkruan: Milazim KRASNIQI

Vetëmenaxhimi i serbëve, sipas planit franko-gjerman, është autonomi personale. Pra është një nga format e autonomisë. Krahas autonomisë territoriale (bashkësia e komunave me shumicë serbe), autonomisë kulturore (arsimi dhe kultura të pavarura nga institucionet shtetërore të Kosovës), krahas autonomisë funksionale (statusi i Kishës Serbe), serbët e kanë fituar edhe autonominë personale. Me këtë lloj autonomie personale, secili serb do të jetë në mënyrë të veçantë i privilegjuar dhe i mbrojtur, vetëm për faktin se është serb. Ndonëse kufijtë e autonomisë personale nuk janë

të kornizuar qartë, është e sigurt se me këtë lloj autonomie sigurohet një mbrojtje speciale e serbëve në raport me shtetin dhe me shumicën. Sipas planit franko-gjerman, vetëmenaxhimi i serbëve si autonomi personale, vlen për të gjithë serbët, kudo që janë, pra edhe jashtë bashkësisë së komunave. Besoj se do të vlejë edhe për serbët jashtë Kosovës, si mundësi e kthimit të stimuluar me fonde e me investime të BE-së, të atyre që janë larguar nga Kosova.

E bashkuar me autonominë territoriale (Asociacionin) me autonominë kulturore (arsimin e kulturën) dhe me autonominë funksionale, (statusin e pavarur nga shteti të Kishës Ortodokse Serbe) autonomia personale i

bën serbët të jenë në Kosovë me status më të lartë juridikë e politikë se sa të gjithë të tjerët dhe de facto i bën vulëmbajtës të shtetit në Kosovë. Pra, me planin franko-gjerman dhe me planin e zbatimit, serbët kanë fituar autonominë territoriale (me Asociacionin), autonominë kulturore (arsim e kulturë të lidhur direkt me Serbinë), autonominë funksionale (me Kishën në qendër) dhe autonominë personale me vetëmenaxhimin në qendër. Shkurt, oferta për serbët me planin franko-gjerman dhe me Marrëveshjen e Ohrit për serbët në Kosovë ka qenë: pranohet kufijtë e jashtëm të Kosovës, ne po ua japim juve në pengmarrje faktike këtë kuazisitet.

Shoqëria civile adreson shqetësimet në raport me institucionin e Prokurorit të Shtetit

Prishtinë, 27 mars - Ushtruesi i detyrës i Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka zhvilluar takim me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, me të cilët ka diskutuar për çështje të ndryshme që bien në kompetencë të Prokurorit të Shtetit.

Në takimin e përbashkët u

shkëmbyen pikëpamje lidhur me përparimin, sfidat dhe gjendjen aktuale në sistemin prokurorial, derisa përfaqësuesit e shoqërisë civile dhanë komentet dhe shqetësimet e tyre në raport me institucionin e Prokurorit të Shtetit.

U.d. Kryeprokurori Kelmendi shprehi vlerësimin e tij për

rolin dhe punën e organizatave të shoqërisë civile që vepronin në Kosovë, të cilat në fokus kanë forcimin e sundimit të ligjit dhe monitorimin e punës së sistemit prokurorial.

Bashkëbiseduesit u pajtuan për avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë brenda kompetencave dhe përgjegjësi respektive.



Kompania e veturave "Volvo" së shpejti do ta hapë degën e saj të re në Kosovë

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetaria e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Arbreshë Kryeziu-Hyseni, ka bërë me dije të hënën se kompania e njohur suedeze e veturave "Volvo" pritet që shumë shpejt ta hapë degën e re në Kosovë.

Kryeziu-Hyseni ka thënë se një gjë të tillë ua konfirmoi ambasadori suedez Jonas Westerlund, me të cilin si komision patën një takim sot. "Një gjë shumë e rëndësishme që ambasadori e përmendi është se po punohet jashtëzakonisht



shumë që të sjellën investitorë të nga Suedia në Kosovë. Na u tha se jo shumë

larg, kompania e veturave 'Volvo' do të hapë degë të re në Kosovë", u shpreh Kryeziu-

Hyseni. Ajo tha se me ambasadorin Westerlund kanë folur edhe

për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe se ka marrë premtimin e Suedisë se do ta ketë përkrahjen e saj në këtë drejtim si udhëheqëse e BE-së për gjashtë muaj. "Biseduam për atë se çfarë po kalon Kosova dhe për ndihmën që Suedia afon për Kosovën. Suedia ka qenë një ndër vendet e para që ka kërkuar anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Pas marrjes së presidencës është e gatshme të na ndihmojë edhe më tutje në këto procese", tha Kryeziu-Hyseni.

KMDLNj: Pasi rryma u shtrenjtua, u harrua tatimi në pronë!

PRISHTINË, 27 MARS - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se pasi rryma u shtrenjtua, u harrua tatimi në pronë.

KMDLNj ka bërë me dije se kohë më parë qytetarët e Kosovës u bombarduan me një rritje marramendëse dhe jonormale të tatimit në pronë, mesatarisht më shumë se 100 për qind, krahasuar me vitin paraprak.

Sipas KMDLNj-së, reagimet ishin të shumta, me një efekt të çastit në vend se kjo rritje e vlerës së tatimit në pronë të kundërshtohet fuqishëm përmes aktivizimit qytetar dhe të gjithë atyre që kanë mandat ta mbrojnë interesin e qytetarit. "Ministria që drejtohet nga Hekuran Murati tërë përgjegjësinë për këtë rritje - plaçkitje përmes tatimit në pronë e adresoi te

komunat duke deklaruar se këto mjete shkojnë në buxhetin e komunave në kohën kur komunat po arsyetohen se Ministria përkatëse ka përgjegjësi dhe se komunat nuk kanë as mundësi e as përgjegjësi ligjore të ndërhyjnë në vendimet e ministrisë. Realisht, qytetarët e Kosovës që pamëshirshëm po plaçkiten, qoftë nga një vendim diskriminues i ministrisë, qoftë nga mungesa e kompetencave të komunave të ndërhyjnë në caktimin e shumës së tatimit në pronë, janë të pafuqishëm të mbrojnë buxhetin familjar dhe biznesor, edhe ashtu të rrezikuar shumë nga kriza e përgjithshme ekonomike", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Në këtë situatë, KMDLNj ka theksuar se komunat kanë



kërkuar nga Ministria e Financave që të mos zbatojë këtë rritje jonormale deri në një vlerësim tjetër, kurse ministria, për ta heshtur dhe zbutur kundërshtimet e arsyeshme të qytetarëve, ka propozuar që komunat t'ua falin nga 100 euro tatimpaguesve ndonëse për këtë nuk ka asnjë bazë ligjore. "E pabesueshme deri ku shkon injoranca dhe arroganca e

atyre që kanë përgjegjësi konkrete për këtë rritje - plaçkitje përmes tatimit në pronë", thuhet në këtë reagim. KMDLNj ka reaguar edhe për energjinë elektrike që parashihet të rritet 15 për qind. "Qeveria e Kosovës në vend se të mbrojë interesin e qytetarëve - votuesve të saj, po i mbron interesat e KESCO-s, ZRrE-së dhe strukturave kriminale në veri të Kosovës që

rrymën e papaguar e përdorin për prodhim të kriptovalutave dhe kultivimin e bimëve narkotike. KMDLNj vlerëson se reagimi i qytetarëve nuk garanton se ata janë të përkushtuar t'i mbrojnë interesat e tyre sikur që ndodhë në vendet me një demokraci shumë më të zhvilluar dhe të qëndrueshme. Shembull tipik e kemi reagimin qytetar në Francë ku standardi është pakrahasimisht më i lartë se në Kosovë por se qytetarët nuk pajtohen me masat e imponuara nga qeveria. KMDLNj e përkujton opinionin se shtrenjtimi i çmimit të energjisë elektrike do të ndikojë në rritje zinxhirore të çmimeve të artikujve tjerë, kryesisht të domosdoshëm sikur edhe të shërbimeve", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Ekonomistët presin recesion në ShBA këtë vit



WASHINGTON, 27 MARS - Shtetet e Bashkuara me shumë gjasë do të përballen me recesion këtë vit si dhe me inflacion të lartë më 2024, kanë parashikuar disa ekonomistë, pas një vëzhgimi gjashtëmuor të situatës ekonomike.

Recesioni përshkruhet si turrje e ciklit të biznesit dhe, për pasojë, ka rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik. Më shumë se dy të tretat e respondentëve të Asociacionit Kombëtar për Ekonominë e Biznesit kanë thënë në një anketë se presin që inflacioni të mbetet mbi katër për qind deri në fund të këtij viti.

Në raport janë përmbledhur përgjigjet e 217 anëtarëve të këtij Asociacioni në anketë, e cila është kryer mes 2-19 marsit, ka thënë organizata përmes një deklarate. Lufta e

Rusisë në Ukrainë dhe pasojat e pandemisë së koronavirusit besohet se janë shkaktarët e inflacionit që ka prekur ekonominë e pothuajse gjithë botës.

Rezervat Federale të Shteteve të Bashkuara e kanë rritur normën e interesit në 4.75 për qind, me qëllim të luftimit të inflacionit, i cili vitin e kaluar ka arritur në nivelet më të larta në dekada.

Rritja e çmimeve është ngadalësuar, duke qëndruar në 6 për qind në shkurt, ndonëse është shifër shumë më e lartë sesa shënjestra afatgjatë e Rezervave Federale prej 2-përqindësh. Mirëpo në mesin e parashikimeve jo të mira ekonomike për të ardhmen, vetëm pesë për qind e respondentëve besojnë se ShBA-ja aktualisht është në mes të një recesioni.

AJAZ EMINI - Ditar (IV)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Informacionet e 24 orëve të fundit

-Gjatë ditës së sotme 36 raketa kishin qëlluar qytetin e Nishit, i cili ndodhet rreth 200 km larg Beogradit, në këtë sulm të NATO's ishin qëlluar depot e karburantëve si dhe rafineria. Gjithashtu ishte qëlluar edhe depoja e karburantëve në Novi Sad, si dhe ura e fundit që kishte mbetur pa u dëmtuar, po edhe depoja e karburantëve në fshatin Bogutovac u qëllua sot nga bombarduesit e NATO's. Në Novi Pazar ishin ndëgjuar më se 20 eksplozime të ndryshme.

Sipas informatave të Beogradit u tha se edhe Prishtina ishte qëlluar nga 15 raketa, si dhe ishte sulmuar edhe baza e forcave operuese të ushtrisë serbe në Kosovë.

Për derisa diplomacia amerikane po fliste për demilitarizimin e Kosovës, pushteti serbo-jugosllav po refuzonte prezencën e forcave ushtarake të huaja në territorin e Kosovës, sepse ligji mbi tërësinë territoriale të Jugosllavisë nuk po lejonte një gjë të tillë. Presidenti i Ukrainës Leonid Kuchma kishte propozuar që në forcat paqëruajtëse në Kosovë duhen të jenë vetëm ato forca, shtetet e të cilave nuk kanë marrë pjesë në bombardimet e NATO's! Ai tha gjithashtu se forcat paqëruajtëse që do të vijnë në Kosovë duhet të kenë besim tek pala serbe, dhe duke thënë se pjesëmarrja e trupave ruse është mëse esenciale!

Ediel 25 prill 1999

Edhe sot koha ishte me shumë të reshura shiu, binte aq shumë shi dhe po bënte aq zhurmë të madhe mbi çadrën tonë sa edhe shiu filloi të depërtojë në mbrendësi të cadres. Gjatë natës na prishi gjumin shumë herë, sepse pikat e shiut na qëllonin si me qëllim drejt mbi kokat tona. Kohë pas kohe duhej të lëviznim shtretërit nga një anë në tjetrën, kinse më mirë që mos të lagemi. Për fat të mirë unë gjeta një copë kartoni të madh, të cilin e rregullova mbi shtretin tim, e vura mbi vete që sadopak të më mbronte nga ramja direkte e shiut. Pra këtë e bëra sa për mos t'u lagur!

Gjatë ditës së sotme dola në teren me kompaninë Raketore "Çarli" (Charlie) me Lancuesit Raketorë MLRS (Multiple Launch Rocket System) të cilët mundë të kishin cakun e sulmit në distancë deri në 640 km. largësi, si dhe cakun e shkatërrimit në përmasa të një stadioni futbolli. Në pamje dukej si një lloj autoblinde e cila mundë të arrinte shpejtësinë deri në 65 km. në orë. Me Lancuesit Raketorë MLRS, ne ishim të shoqëruar edhe nga 2 Hamveev (xhipa ushtarak) si dhe një kamion ushtarak edhe disa ushtarëve të armatosur. Nga baza ushtarake e Armatës Amerikane në Rinas ne dolëm për disa kilometra jashtë bazës, jo edhe aq shumë larg Aeroportit të Rinasit, për të bërë kalibrimin e pikave të ndryshme sulmuese në rastëse do të na ipej komanda për ndonjë sulm të këmbësorisë kundër forcave të armikut serb. Po, qëllimisht sepse sulmi mundë të bëhej edhe në



17 Maj 1999 Kukës/Shqipëri, Ajaz Emini, Gjenerali Kudusi Lame dhe Kapiteni Walter J. Wiggins i Njësisë së Forcave Speciale të Armatës Amerikane

distancë nga mbrendësia e Shqipërisë, prej ku mundë që të qëllonin edhe qytetin e Beogradit sipas fjalëve të ushtarakëve të cilët po i shoqëroja gjatë këtij misioni. Pas disa orësh kalibrimi në fushën e hapur, përsëri u kthyem mbrenda bazës ushtarake ku edhe morëm zhavor për t'i shtruar rrugicat për në shtret mbrenda çadrës sa për t'u mbrojtë sadopak nga balta që ishte gjithkund. Pjesën tjetër të ditës e kaluam të qetë, duke lexu një libër xhepi ushtarak që quhej "Doracaku i Ushtarëve" (The Solder's Handbook), të cilin na i kishin dhënë eprorët ushtarak në Aeroportin e Ramstein'it në Gjermani, para se të nisemi për në Shqipëri. Ishte një libër doracak i vogël ushtarak në të cilin jepeshin informacione elementare për tërë rajonin ku po bëhej zbarkimi i trupave amerikane, aty jipej një përshkrim i shkurtë për shtetet: Shqipërinë, Jugosllavinë, Maqedoninë, ku aty përshkruhej ana gjeografike, nacionalitetet, religjionet, palët e konfliktit, liderët e këtyre palëve si dhe llojet e armatimeve që përdorin. Me më tepër detaje ishin të përshkuara pjesët e palëve në knflikt: ajo e UÇK's dhe pala serbe. Aty jepeshin detajet edhe të emrave me fotografi të Shtabit të UÇK's, si dhe të shtabit të përgjithshëm ushtarako policor të Serbisë. Aty përshkruhej edhe armatimi i tyre që posedonin në luftë si: UÇK'ja si dhe pala serbe.

Informacionet e 24 orëve të fundit

-Aviacioni i NATO's sot bombardoi transmetuesin e televizionit serb, 10 mila (15 Klm.) në afërsi të Beogradit, mirëpor vetëmse pas disa orësh më vonë, TV- serb përseri filloi transmetimin e programit të tyre, mirëpor me kapacitet tepër të kufizuar.

Që nga fillimi i bombardimeve numri i refugjatëve kosovarë kishte arritur në 600,000, kurse edhe disa qindëra mijëra refugjatë kosovarë ende po endeshin maleve dhe vendbanimeve mbrenda Kosovës. Ata po kërkonin rrugën e shpëtimit, për të ikur jashtë kufinjve për shkak të agresionit të egër serb...

E hënë 26 prill 1999

Qysh kur erdhëm në Shqipëri, koha ishte thujse çdo ditë me shi dhe e ftohtë. Edhe sot binte shi! Me kompaninë "Bravo" u nisëm në drejtim të Lezhës. Edhe sot sikur ditëve të më parme ishim në shoqëri të

12 automjeteve ushtarake: hamvis, autoblinde, kamiona ushtarak si dhe Lancuesit Raketor MLRS.

Shkuam deri në afërsi të qytetit të Lezhës, atje ku më 2 Mars 1444 nën udhëheqjen e kryetrimt Skenderbeut ishte bërë Kuvendi i Lidhjes së Lezhës. Në Lezhë u bë edhe aleanca ushtarake në mes të prijësve të krahinave arbërore dhe atyre serbe, për tu mbrojtur nga Perandoria Osmane.

Lezha më vonë njihet edhe si vendi ku ishte varrosë pas vdekjes edhe kryetrimi i Arbërisë, Gjergj Kastrioti-Skenderbeu.

Gjatë rrugës ndalua në disa vende ku po bëhej kalibrimi Lancuesve Raketor. Kjo bëhej me plan për në rastë të ndërhyrjes së trupave të këmbësorisë së NATO's kundër forcave serbe në mbrendësi të Kosovës! Gjatë rrugës hasëm në shumë turma njerëzish të moshave të ndryshme, të rinjë dhe të moshuar, dhe që rregullisht na prisnin me duartrokkitje dhe bërtisnin me duart lartë UÇK, UÇK, UÇK, e disa të tjerë po na përcillnin lëvizjet e kolonës tonë disi të habitur. Gjatë rrugës në shumicën e

vend ndalimeve, menjëherë njerëzit nga kureshtja na ofroheshin të shohin se ç'bënim. Atëherë kur unë nga mesi i ushtarëve i përshëndesja në shqip, për një kohë ata mbeteshin disi të habitur se si ushtari amerikan po na flet shqip. Ata përmjeherë ma kthenin "O ju dini të flisni shqip?". Unë ia ktheja: "Po ore, a po më kuptoni, edhe unë jamë shqiptar si ju!" Pastaj vijonin një mori pyetjesh të ndryshme "Prej nga vini, ku po shkoni, kur do të filloni sulmin, a do ta çlironi edhe Shqipërinë nga liderët tanë?" etj. Nga njerëzit prej të cilëve siç po shihnim, ishin mjaftë të mërëzitur me sistemin e tyre udhëheqës! Pas 4 orësh lëvizjeje, përsëri u kthyem në bazën ushtarake të Aeroportit të Rinasit.

Sot për darkë për herë të parë na u servua ushqim i nxehtë, sepse deri më sot ishim ushqyer vetëm me ushqim të paketuar ushtarak "Ushqim i gatshëm për t'u ushqyer" (MRI), i cili veçëse kishte filluar të na mërëzitet! Darka ishte e mirë dhe mjaftë festive, ku kishim ushqim të nxehtë, e përbërë nga një copë mish lope (T-Bone Steak), me patate të fërguara, tamak misri si dhe sallatë jeshile. Pas kësajë darke që të gjithë të kënaqur u shpërndamë në drejtimet tona, secili po ikte në drejtim të çadrave për t'iu kthyer pushimit të rahatshëm. Gjatë mbrëmjes së sotme, dikur vonë rreth orës 1:30 të mëngjesit nëpërmjet të një tranzistori të vogël të cilin e bleva prej një ushtari i cili po kthehej për në Gjermani, ndëgjova se kishte ndodhe një aksident me helikopterët Apache AH-64 gjatë manevrimeve natën diku afër kufirit me Kosovën, rreth 50 Milja (80 km.) larg Aeroportit të Rinasit. Në këtë aksident kishin pësuar dy pilotët amerikan me lëndime të lehta. Këta ishin ushtarë të cilët sigurisht se i kishim takuar

sepse ishin nga baza e Rinasit ku ishim edhe ne, poashtu edhe helikopterët ishin pas çadrës ku ishim vendosë edhe ne. Sipas informacioneve vlera e një helikopteri Apache AH-64 kushtonte \$16 Milion, por përsëri vlera e pilotit është shumë më e madhe dhe e pazëvendësueshme.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sot ishte dita 34 e bombardimeve të NATO's. Sipas informatave të forcave aleate, thuhet se sot aviacioni i NATO's kishte qëlluar urën e fundit mbi lumin Danub në Novi Sad të Serbisë. Gjatë kësajë dite u qëllua edhe depoja e karburantëve në afërsi të Valevës, u qëllua edhe aeroporti i Somoborit në afërsi të kufirit të Hungarisë.

Në rrethin e Prishtinës ishte qëlluar aeroporti civilo ushtarak i Sllatinës. Gjatë misionit të trajnimeve në Shqipëri në ditën e sotme në orën 22:40 të mbrëmjes ndodhi edhe aksidenti i helikopertit Apache AH-64 për të cilin nuk u dhanë shumë informata, por për fat të mirë që të dy pilotët kishin shpëtuar.

Nga informatat e NATO's, tani në bazën ushtarake të Rinasit në Shqipëri kishim 23 helikopter Apache, si dhe 33 helikopterë ndihmës, 18 Lancues Raketash MLRS me 3,400 ushtarë amerikan, që janë të gatshëm për në akcion kundër forcave serbe. Tani po bënim planet edhe për formimin e një force prej 200,000 ushtarë të Aleancës së NATO's. Kjo bëhej në rast të ndërhyrjes së këmbësorisë kundër forcave jugosllave, për çka edhe vetë Presidenti Clinton tha se është i gatshëm që të thirrë edhe 33,000 rezervistë amerikan...

E martë 27 prill 1999

Tani unë më kisha hy në rutinën ushtarake. Si çdo ditë edhe sot u zgjuam rreth orës 6:00 të mëngjesit, rreth orës 7:00 morëm ushqimin e mëngjesit, dhe gjatë asajë kohe mu afroa Kapiteni Lerner me një officer tjetër. Ata më njoftuan se pas ushqimit duhet të bëhem gati (edhe pse çdoherë isha i gatshëm për akcion) sepse do të nisemi menjëherë në detyrë. Do të dilnim në teren për të bërë verifikimin edhe të disa pikave tjera strategjike, pasi se tani veçëse po pritej urdhëri për sulm nga Shtabi i Përgjithshëm i NATO's (Amerikan).

Pritej dhezja e raketave nga pala jonë prej këndeje në mbrendësi të kufirit të Shqipërisë, për t'i treguar armikut serb se ne jemi të gatshëm për t'i luftuar deri në fund. Kërcënimin ynë ishte i vërtetë, nuk ishin si ato të lidshimit serb që çdo ditë po e shtynin me rrenat e tyre bajtate. Ishte koha për t'i treguar se këtu nuk kishte shaka.

Dikur pas orës 3:00 pas mesnate, u nisëm në një kolonë të gjatë me Lancues Raketash MLRS, shumë autoblinde dhe automjete të tjera të rënda dhe të lehta ushtarake. Të gjithë u nisëm pa bërë shumë zhurmë dhe me dritat e automjeteve të bllokuara që mos të shiheshin në terr nga largësia. Edhe kësajë here morëm të njetën rrugë drejt Fushë Krujës, të cilën rrugë e

kishim kaluar shumë here. Dolëm lartë në kodrinat andej prej nga ishte planifikuar sulmi! Kjo ishte dita më e lumtur për mua, si dhe të gjithë ushtarakëve që kisha për rreth, sepse koha jonë në Rinas veçese kishte filluar të tregojë monotoninë e sajë. Isha shumë i lumtur, pasi se më në fundë po mirrja pjesë edhe unë në një sulm direkt së bashku me Ushtrinë Amerikane mbi forcat gjakatare serbe. Për forcat të cilat kishim të mbjellur shumë urrejtje. Po, për shkak të krimeve që po bënin anë e mbanë Kosovës mbi popullatën e pa mbrojtur shqiptare. Ky sulm kundër forcave serbe do të shënonte edhe sulmin e parë nga tokat shqiptare, prej Forcave të NATO's. Njëri nga eprorët ushtarak amerikan erdhi tek unë dhe më tha: "Cakun e parë të sulmit me raketa ndaj ushtrisë serbe që do të fillojmë sonte është një cak në afërsi të qytetit të Prishtinës!" Së bashku që të gjithë u gëzuam pa masë, të cilin gëzim e shprehëm me grushta lartë të gjithë së bashku. Më në fund na erdhi dita që të shporrim forcat fashiste serbe nga trojet shqiptare, atje ku kishin bërë dhe po bënin masakrat e pa numërta mbi njerëzit e pa fajshëm dhe të pa mbrojtur. Ishte gëzim sepse me futjen e këmbësorisë së NATO's në Kosovë, njëherë e përgjithmonë do ta largonim pushtetin dhe forcat e Serbisë nga Kosova. Po nga atje ku po bënin gjenocid dhe pastrime etnike. Ishte ky çasti kryesor për të cilin edhe iu kisha bashkangjitur Forcave të Armatës Amerikane dhe e kisha pritë me vite të tëra vetëm e vetëm që ta shohim dhe ta përjetojmë Kosovën e lirë!

Pas të gjithë këtyre manovrimeve që patëm, përsëri edhe sot mbetëm të dëshpëruar. Mbetëm të dëshpëruar sepse ishim në pritje të urdhërimit për sulm, kurse ata nga qendra na thanë se edhe sot nuk do të ketë sulm. Shkaku ishte se i paskan disa bisedime NATO me palën serbe. Që tani po zhvilloheshin takime për të ardhë në një ujdi në mes të tyre! Ashtu të dëshpëruar me të tërë atë kolonën ushtarake që ishim, njejtë gjithashtu me dritat e fikura të automjeteve gjatë territ të mëngjesit filluam të kthehemi prej nga kishim ardhur. Po, ashtu të dëshpëruar vetëmse nëpërmjet të dylbive të natës (Night vision binoculars) u kthyem në bazën tonë ushtarake të Rinasit.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme NATO bombardoi në Beogradin e Ri ndërtesën 23 katëshe në të cilën ishin zyrat e Partisë Socialiste të Millosheviqit, si dhe zyrat e 8 radio stacioneve të Beogradit. Kjo ndërtesë ishte në shënjestër dhe në bombardimet e mëherëshme të 21 Prillit 1999. Në shënjestër të bombardimeve sot ishin edhe disa caqe rreth qendrës së Prizrenit, qytet kosovar rreth 11 milja (16 km.) nga kufiri me Shqipërinë. Mediat serbe lajmëruan se disa raketa qëlluan Prishtinën, Pejë dhe Deçanin. Aeroplanët e NATO's qëlluan edhe në Jug të Serbisë fshatin Surdulica. Gjatë natës u ndëgjuan sirenat e rrezikut edhe në Prishtinë dhe në Podgoricë të Malit të Zi, kurse eksplozimet u ndëgjuan në drejtim të aeroportit të Podgoricës. Sipas informatave të NATO's, aeroplanët e tyre F-15 kishin qëlluar me sukses garnizonin ushtarak serb në Surdulicë.

Sipas informacioneve të sotme, rreth 5,000 refugjatë shqiptarë kishin kaluar kufirin për në Maqedoni, një eksod refugjatësh i shkaktuar nga forcat serbe që po operonin rreth qytetit të Prishtinës. Në SHBA, presidenti Clinton kishte autorizuar Pentagonin që të thërrasë dhe 33,102 rezervista ushtarakë që të jenë të gatshëm për në konfliktin e Kosovës, si edhe 2,116 ushtarë nga Rezervistët e Forcës Ajrore si dhe Gardës Nacionale.

Në negociatat me Rusinë çelësi kryesorë ishte që NATO'ja po refuzonte në vazhdimësi që të ndërprisë bombardimet, gjithashtu edhe lidhshipi jugosllav po refuzonte gjithsesi që të pranojë forcat e armatosura të NATO's si forcë paqëruajtëse për të ruajtur paqen në Kosovë. Beogradi donte që paqëruajtësit të mos kenë armë ose të jenë vetëmse me armë të lehta që ishte krejtësisht në kundërshtim me kërkesat e NATO's...

E mërkurë 28 prill 1999

Pas ngrenies së mëngjesit, njëri nga eprorët ushtarak që ishte përgjegjës për terrenin ku ishim vendosë, më ftoi që përsëri të shkojmë tek fqiu shqiptar i cili me gjithë familjen e tij ende po qëndronte në shtëpinë e cila ishte shumë afër vendqëndrimit tonë ushtarak. Atij të shkretit ende nuk po ia paguanin shtëpinë për shkak të mungesës së dokumentacionit (tapisë), e për çka fqiu shqiptar po shtrej se e kishte humbur. Ai po na kushtëzonte se për derisa nuk ia paguajmë shtëpinë, pra pronën e tij, ai me gjithë familjen e tij do të qëndrojë aty. Pa marrë parasysh se i ishte urdhëruar që të largohet nga ky objekt sa më shpejtë për shkak të sigurisë ushtarake, ai nuk largohej. Pas kryerjes së bisedës me të, përsëri vazhduam me daljen tonë tani të përditshme dhe të zakonshme. Dalja në teren ishte dalja jashta Aeroportit të Rinasit për të bërë verifikimin e objektivave tjera strategjike të Raketë Lancuesve MLRS. Kjo ditë ishte një ditë shumë e mirë me diell edhe e ngrohët, e cila thuajse për menjëherë filloi me tharjen dhe largimin e të gjithë asajë balte që kishim. Po, asajë balte e cila na kishte merrtur jetën qysh prej arrijtes tonë këtu në Rinas të Shqipërisë. Dikur më vonë, para perëndimit të diellit filluan përsëri me manevrimet e tyre edhe helikopterët Apache AH-64, aty ku kishim 6 prej tyre shumë afër neve. Zhurma e tyre ishte e pa durueshme, si dhe me pluhurin që ngritnin në ajër na merrziste pa masë. Tani përsëri filloi një rigë shiu. Për rigat e shiut nuk na kishte marre malli aq shumë, pasi se qyshë nga ardhja jonë këtu në Shqipëri, thuajse çdo ditë kishim pasë reshje shiu.

Sot për dallim nga ditët tjera, aty afër çadrës tonë kishin dalë jashtë shumë ushtarë. Ata kishin vu një karrige, ku pashë se disa ushtarë po bënin punën e berberit. Po, po ia hiqnin flokët shokëve të tyre. Duke lakmuar punën e tyre edhe unë vendosa t'i pyes se nëse kanë kohë që edhe mua të më bëjnë frizurën ushtarake ashtu si të tyre, përçka edhe shkova edhe iu luta ushtarit berber që të m'i hjekë edhe mua flokët. Më tepër e kisha për shkak se higjiena për mbajtjen e flokëve nuk na ishte në nivel të duhur, pasi se nuk kishim ujë të nxehtë për pastrim. Ushtari mbeti i habitur kur



29 Maj 1999 Kukës/Shqipëri, me Njësinë e Forcave Speciale të Amerikës, në rreshtin e fundit Gjenerali Arbëresho-Amerikan John W. Hendrix dhe Gjenerali Kudusi Lama Komandant në Divizionin e Kukësit

i kërkova shërbimin e tij duke menduar se unë isha civil ushtarak. Unë mundesha që të mbaja flokët si të doja, pasi se më njihnin si civil, por me uniformë ushtarake. Në fillim reagoi duke më thënë: "Jo, nuk dua unë që ta prishi frizurën tënde, gjithashtu ne kemi vetëmse një stil, stilin tas, zero!" edhe filluan që të qeshen që të gjithë në zë!

Ishte tepër e bezdisëshme të mbaja flokët e gjata, kur tërë kohën isha në uniformën ushtarake, me helmetë, xhakët anti plumb dhe sendet tjera që ishin obligative të barten në ç'do kohë dhe në ç'do hapësirë. Këtë obligim e kishte ç'do pjesëtarë ushtarak, edhe e gjithë kjo uniformë të bënte të djersitesh. Vendosa që edhe unë si ushtarët tjerë t'i hjekë flokët nga një ushtar që ua hiqte flokët shokëve të vetë me një stil që më përkujtonte kohën kur isha fëmijë në fshat. Më kujtoi kohën kur gjatë ç'do pranverë i qethnin delet, që të gjitha vetëmse në një stil, stilin zero! Pasi i hoqa flokët, e pastrova kokën me pak ujë të vakët që e ngrohni mbi kofortin e thjeshtë që kishim për nxemje në çadër. Ujin e vktë e bënim në disa tasa alumini 3-4 litërshë që i kishin marrë nga kuzhinierët ushtarak pas shfrytëzimit të ushqimeve të konzervuara në to. Pasi pastrova kokën u ktheva mbrenda në çadër, ku zakonisht shkonim vetëmse për të bërë gjumin. Mbrenda çadrës nuk ishte askush përveçese kolegut, gazetarit të Associated Press Dough Melgrin i cili po shkruante diçka. Me të hyrë unë mbrenda ai filloi të qeshet në zë me mua, pasi se më pa tanimë frizurën ushtarake! Mu afrua afër shtratit tim duke më uruar së pari frizurën e re, e pastaj më pyeti se a mundet të pranojë që ai të bëjë një intervistë me mua për agjencinë për të cilën e raportonte ai? "Po i thashë, pse jo", urdhëro bisedojmë! Prej afër Douge nxorri një bllok të vogël nga xhepi, edhe filloi ashtu thjeshtë me disa pyetje të tij. Ai më pyeti në lidhje për rrugën time të largimit nga ish Jugosllavia për Amerikë, pastaj punën që po ushtroja në Amerikë, takimin me bashkëshorten Shahadijen e deri te vendimi i ardhjes time këtu në Shqipëri. Gjithashtu më pyeti edhe

për atë se ç'më shtyri të lë profesionin e menaxherit, të lë familjen dhe të gjitha të mirat e Amerikës, për t'iu bashkangjitur Armatës Amerikane. Më pyeti se a durohen gjitha këto kushte aspak të mira, kur nuk dihet se si do të përfundojë lufta në Kosovë!

Pas përfundimit të intervistës, e pyeta se ku mundë ta shoh këtë intervistë timen?

Doug mu përgjigj: "Kjo intervistë që bëmë, tani mundë të botohet gjithëkund nëpër të gjitha gazetaret e ndryshme të botës. Në të gjitha 5 kontinentet e kësajë botë!" Gazetarit i pëlqeu pa masë historiku im jetësor, dhe më tha se: "Tregimi yt është shumë interesant për të gjithë lexuesit dhe shumicën e gazetave. Ai garantoj se ky tregim do të lexohet në të gjitha kontinentet. Më tha se është mëse i sigurt se gazeta që shtypet në Cleveland, Ohio, se ajo mundë dhe duhet të jetë një ndër gazetaret e para që do të blejë intervistën, pasi se ka të bëjë me një pjesëtarë të Armatës Amerikane të komunitetit të tyre.

Ashtu siç më tha gazetari Dough Melgrin, ashtu edhe ndodhi. Të nesërmen kjo intervistë ishte botuar në gazetën e përditshme të tirazhit më të madh të Ohio's "The Plain Dealer" që shtypej në qytetin ku po jetonim në Cleveland! Kjo ishte edhe informata e parë edhe për familjen time në Cleveland, sepse nuk ishim ndëgjuar me to dhe nuk kishim kurrëfarë kontaktesh që nga koha kur erdhja në Shqipëri! Gazetari Daugh më spjegoi edhe për jetën e tij, më spjegoi për profesionin e tij si gazetar dhe jetën e tij private. Ai më tregoi se ishte me prejardhje Irlandeze, dhe si gazetar për Associated Press kishte raportuar gati se nga të gjitha vendet me konflikte nëpër botë.

Derisa bisedonim me Daug, erdhi një ushtar dhe më tha se eprori i tij më fton që përsëri të shkojmë te familja shqiptare aty afër, të cilëve iu ishte urdhëruar që të largoheshin nga shtëpia e tyre. Më ftoi që të shkojmë te familja që iu ishte urdhëruar të largohen nga shtëpia për shkaqe sigurie, sepse ishte tepër afër çadrave ushtarake. Mirëpor kësajë here më kërkohet edhe që të

bëja punën edhe të ndërmjetësuesit, e më pakë të përkthyesit. Me ndihmën time arritëm të bëjmë pajtimin për pagimin e pronës së familjes shqiptare Kallari, dy vëllezërve dhe nënës së tyre 70 vjeçare. Pas marrëveshjes që bëmë, që të gjithë anëtarët e familjes u merrziten, e sidomos nëna e tyre ishte merrzitur tepër shumë. Ajo ishte merrzitur për shkak se tërë jetën e kishte kaluar në atë shtëpi, dhe tani iu duhej të largoheshin. Lokja mu drejtua mua dhe më tha: "O biri im, nuk dua të largohem nga kjo shtëpi. Kjo është shtëpia ku unë dua edhe të vdesë, sepse nuk më kanë mbetur edhe aq shumë vite që të jetojë!" Lokja ishte në moshë mbi të 80'at. Pas një pauze plaka filloi të flasë përsëri duke mu drejtuar mua me lot në sy, lotët e së cilës edhe neve na e kaputën shpirtin. Plaka përsëri vazhdoi të fliste dhe me tha: "O biri lokes, njëherë Enveri na përzuri dhe na i mori të gjitha, edhe shtëpitë, e tani po e përjetoj përsëri lëshimin e vatanin edhe një here. Ky vend i imi ka shumë kujtime, edhe nuk mundë që të harrohet lehtë. Këtu kalova pjesën më të gjatë të jetës time, këtu u plaka o bijtë e mijë!" Më vonë pasi lokja u qetësua nga të folurit, edhe unë me zemër të lënduar ia prita: "Oj loke, duhet të na kuptoni, se ne nuk po bëjmë asgjë që t'ju lëndojmë zemrën tuaj, mirëpo ky është shkaku për sigurinë tuaj po edhe për ushtarakët. Ne erdhëm nga Amerika e largët, dhe ne jemi këtu që të ndihmojmë vëllezërit dhe motrat tona nga Kosova. Po ata të cilët po dëbohen me dhunë prej shtëpive të tyre, po plaçkiten, po digjen, po dhunohen, po vriten, po masakrohen dhe po terrorizohen nga gjakëpirësit sllav. Ata janë shumë e shumë më keq se ju, të paktën juve po iu paguajmë dhe pse nuk keni dokumentacion pronësie, edhe po iu tregojë dhe garantojmë se ne nuk do të jemi për shumë kohë këtu! Shpresojmë se brenda një kohe të shkurtër do të largohemi përgjithmonë prej këndeje, e juve mundë që përsëri të ktheheni në këtë vend tuajin, sepse destinacioni ynë është Kosova, e jo Shqipëria!" Lokja që ishte e merrzitur

aq shumë gjërë më tani, disi u kthjell pas fjalëve të mia që i thashë, edhe m'u drejtua duke më thënë: "Eja biri i lokes që të përqafoj njëherë. Më fal për gabimin që bëra, po e shoh se nuk qenka lehtë që të ndërrosh vatanin edhe pse është në mënyrën më paqësore dhe me pagesë, e ku më siç po i ndodhë motrave dhe vëllezërve tanë në Kosovë!"

Shtëpia e tyre ishte e vogël, me material qerpiç- lloçi, pra tulla balte dhe tepër e amortizuar. Dukej sikur t'ishite një lloj shtalle, mirëpor për këtë familje ajo ishte pallati më i bukur i botës! Për këtë shtëpi, familjes Kallari Armata Amerikane i bërnë shpagimin mjaft korrekt dhe të volitshëm. Ndoshta edhe me mbivlerë për standardin shqiptarë të kësaj kohe, ku i paguajtën \$20.000. Pas marrëveshjes që bërnë, njëri nga vëllezërit thirri gruan e tij që të na bëjë dhe të na gostisë me nga një kafe turke, e cila pas pak minutash pa kurrëfarë vonese na i solli në oborr aty ku po bisedonim. Ajo solli me kafetë edhe nganjë gotë raki shtëpie. Ne të gjithë së bashku me kolonelin Konrad që kishte ardhur enkas që të zgjidhnim këtë problem si dhe kapitenin Lerner, të gjithë së bashku edhe me dy vëllezërit Kallari dhe loken nënën e tyre i ngritëm gotat, doli për lirinë sa më të shpejtë të popullit shqiptarë në Kosovë! Në marrëveshje nga pala amerikane morëm pjesë: unë Ajaz Emini, Koloneli Konrad dhe Kapiteni Lerner kurse nga pala shqiptare ishin familja Kallari, një punëtor i sigurimit, Komandanti i Aviacionit Shqiptarë dhe një përkthyes i tyre. Menjëherë pas marrëveshjes filloi zhvendosja e familjes Kallari me bartjen e plaçkave të tyre, e po në të njëjtën kohë edhe nga pala e Ushtrisë Amerikane filloi bartja e çadrave nga "Kampi i Baltës" në anën tjetër afër shtëpisë së familjes Kallari.

Planifikohet që menjëherë pas largimit të familjes Kallari, të gjitha ata ushtarakët të lëvizin në atë pjesë, sepse aty ishte toka e terur dhe nuk kishte baltë. Atje ku ishim vendosur, sipërfaqja e sajë ishte shumë e pa përshtatshme nga uji që kishim nën këmbë, por ishte edhe e rrezikshme sepse ndodheshim shumë pranë pistës së aeroportit të Rinasit.

Qysh nga ardhja ime në Shqipëri nuk pata asnjë lidhje me pjestarët e familjes time, për shkak se edhe ato lidhje telefonike që kishim në aeroport ishin lidhje tepër të dobëta, që kënë na i kishin siguru si linjë speciale për tu shfrytëzuar nga pjesëtarët ushtarak amerikan. Edhe sot përsëri tentova për të marrë në lidhje telefonike pjesëtarët e familjes sime por krejt ishte e kotë, sepse nuk munda të kontaktoja askend!

Edhe sonte si në mbrëmjen e më herëshme, përsëri po pritnim urdhërin nga Shtabi i Përgjithshëm i NATO's për dhënien e dritës së gjelbërt, për dhezjen e raketave kundër caqeve të forcave serbe. Mirëpo, edhe kësaj here përsëri nuk u ndëgjua asgjë. Përsëri dështuam nga politika e Brukselit që tani për një kohë veçese kishte filluar të bëhet monotone dhe banale. Edhe pjesëtarët e rregullt ushtarak që ishin aty, ishin lodhë nga pritja e kotë të cilët më thonin se kemi ardhë këtu për të kryer punë e jo për të qëndruar në mes të kësaj balte!...

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme sulmet e NATO's kishin vazhduar me bombardime në një lagje në jug të Beogradit. Sipas informatave të agjencisë së pavarur Beta, ata lajmëruan se në mëngjesin e sotëm NATO'ja kishte qëlluar kazernat ushtarake në Topçider dhe Koshutnjak. Thuhet se forcat serbe ishin evakuuar nga këto kazerna ndër më të mëdhatat të Jugosllavisë pakë kohë para se të fillonin bombardimet. Për aty thuhet se: Aty nën tokë gjendet edhe bunkeri më i madh të cilin e shfrytëzon shpeshëherë edhe Presidenti Jugosllav Slobodan Millosheviqi. Në Paraqin u sulmua depoja e karburantëve, poashtu edhe në Pozhegë që gjendet rreth 70 milja (90 km.) në jug të Beogradit. Gjatë natës u qëllua edhe rafineria e Novi Sadit, si dhe depoja e karburantëve në Smederevë që ishte 25 milja (35 km.) nga Beogradi. U bombardua edhe ura kryesore mbi Lumin Sava, e cila ishte veçese disa milje në perëndim të Beogradit. Gjatë kësaj kohe kishte pasë edhe tre sulme të gabuara me raketa që kishin ra në teritorin bullgar, mirëpor pa viktima gjatë sulmeve kundër Jugosllavisë. Aeroplanët e NATO's kishin kaluar gabimisht mbrenda kufirit bullgar, ku çka ata nuk kishin leje për të kaluar mbi territorin e tyre.

Në 24 orët e fundit rreth 2,000 refugjatë kosovarë kishin kaluar kufirin e Shqipërisë, të cilët ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre nga rrethi i Gjakovës...

E enjte 29 prill 1999

Edhe sot ishte një ditë e bukur dhe me diell, ishte një ditë perfekte për të bërë një dush, edhe atë me ujë të ftohët sepse ende nuk kishin rregulluar furnizimin me ujë të nxehtë. Mora një bidon 5 galonësh (rreth 19 litrash) me ujë prej cisternës ushtake që kishim afër,

edhe u nisa për në banjo e cila ishte bukur largë nga çadra jonë, në anën tjetër të livadhit. Për fat timin askush nuk kishte qenë në banjo, sepse shpeshëherë këto banjot ishin gati se çdo herë të nxanuna nga ushtarët. Aty ishin 3 dushe, 2 prej tyre i mbusha me ujë me planin që pasi ta kryej njërën të kalojë tek e dyta. Dushet ishin të bëra në mënyrë shumë të thjeshtë, ishin strajca lëkure të cilat i mbushje me ujë dhe vareshin lartë në varësen që i kishin bërë dhe të cilat kishin fundet e rregulluar çezmë me shoshë. Kjo ishte pakë a shumë sikur lodra fëmijësh për të lozë gjatë ditëve të verës kur bënte vapë. E lëshova njërën. Në fillim uji ishte trishtues sepse ishte i ftohët, mirëpor pas pak pakë kohe u adaptova edhe pse ishte i ftohët të dukej joshës dhe mjaftë freskues, se edhe trupi iu adaptua temperaturës së ftohtë. Kishte kohë që nuk patëm mundësi bile të largojmë as djersën nga uniforma dhe xhaketat e rënda me anti plumb që bartnim. Pasi e kryeja strajcën e pare, kalova tek e dyta dhe vazhdova me pastrimin e të gjithë trupit. Edhe pse shosha nuk lëshonte aq shumë ujë, merrte bukur kohë të gjatë që të bëje pastrimin siç duhej, por kuptohet me ujë të ftohët. Tani edhe larja ishte bërë më e lehtë, pasi se i kisha hjekë flokët një ditë më herët, çka më kursente edhe në ujë dhe shampun! Pas pastrimit nuk pata aq shumë punë perveçese për disa minuta që ndërmjetësova përsëri me familjen tani të mirënjohur Kallari, të cilët ende nuk i kishin lëvizë të gjitha gjërat e tyre prej shtëpisë. Ata tani më treguan se ende nuk ua paskan dorëzuar lekët e shtëpisë. Pas këtij takimi, përsëri u ktheva te çadra dhe fillova që t'i shkruaja një letër familjes time në Cleveland. Po vendosa t'u shkruaja sepse ishte e pa mundur të bisedoja me telefon, për çka e dija se tani me siguri se janë bërë edhe merak se ç'po ndodhte me mua që nuk iu isha lajmëruar. Në kohën kur fillova ta shkruaj letrën, filloi edhe manovrimi i helikopterëve Apache. Në të njëjtën kohë për çdo ditë ndodhte kjo, të cilët ma prishën rahatimin me zhurmën dhe pluhurin që na bënin. Kjo për ndryshe do të ishte një kohë e mire shkrimi, po mos të ishte zhurma e helikopterëve në livadhet e Rinasit. Aty përballë kishim malet e larta të Krujës që dukeshin mjaftë atraktive, aty ku ishte edhe kalaja e mirënjohur dhe muzeu historik i Gjergj Kastriotit-Skenderbeut. Edhe sonte po pritej fillimi i sulmit me raketa, nga grupi i artilerisë me të cilat isha edhe unë prej ditës time të parë këtu në Aeroportin e Rinasit

të Shqipërisë. Tani sa kuptova se përsëri nuk do të ketë sulm, pasi se edhe helikopterët Apache ende nuk na qenkan të gatshëm për sulm! Meqenëse koha ishte e mire dhe me diell, tani edhe numri i bombardimeve të Aviacionit të NATO's veçese ishte në rritje mbi forcat paramilitaro-ushtarake serbe.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Kësaj radhe bombardimet e NATO's kishin vazhduar edhe në bregdet, në Bar dhe Petrovac, si dhe ishte qëlluar edhe aeroporti ushtarak në Podgoricë të Malit të Zi. Edhe pse Mali i Zi ishte më pro perëndimorë, u mundua që gjatë konfliktit që të mbetej neutral gjatë gjithë kësaj kampanje. Aktivitetet e forcave Serbe me qëllim apo jo, e detyruan NATO'n që të sulmojnë dhe mbrenda Mali të Zi. Gjenerali Giuseppe Marani tha se aviacioni jugosllav nga Podgorica është shumë afër forcave të NATO's në Shqipëri, dhe për të cilat janë kërcënim eminent, për atë edhe duhet sulmuar. Gjatë ditës së sotme aleanca qëlloi edhe vendlindjen e Millosheviqit, qytetin e Pozharevcit, i cili gjendet 50 milje në juglindje të Beogradit. NATO'ja qëlloi edhe antenat e radios në afërsi të Prizrenit, dhe gjithashtu u sulmuan edhe trupat e policisë speciale serbe në brendi të Kosovës. Detonimet ishin ndëgjuar edhe në Podgoricë, atje ku po sulmohej për të tretën herë mbrenda 12 orëve. Air Marshal John Day i trupës mbrojtëse britaneze tha se forcat ajrore jugosllave nga Podgorica kishin sulmuar edhe refugjatët shqiptarë në Kosovë. Pentagoni lajmëroi se tani ia kishte bashkangitë sulmeve ajrore të NATO's edhe 10 bombardues B-52 të Forcave Ajrore Amerikane në Evropë. Sekretari i Mbrojtjes së SHBA'së William Cohen tha: "Ne do të fillojmë të sulmojmë për më shumë orë si dhe më shumë caqe, si dhe prej shumë kahjeve". Disa bombardues të mëdhenjë B-52 ishin të angazhuar në sulmet e NATO's që më herët në Operacionin e Forcave Aleate...

E premte 30 prill 1999

Përsëri edhe sot mbajti një ditë shumë e bukur pranverore, me diell dhe e ngrohtë. Edhe sot për mua nuk ishte aq ditë e nxanun. Dola dhe ia dhashë një qark ecjeje rreth çadrave ku ishim, prej ku edhe pashë se familja Kallari veçese po i bartnin plaçkat e tyre nga shtëpia. Nga kjo po shihej se së shpejti do të largoheshin prej aty. Pakë më herët erdhi edhe Kapiteni Lerner, dhe në bisedë e sipër ma bëri me dije se sa po të largohet familja Kallari nga shtëpia e cila tani ishte rrethuar nga çadrat e forcave ushtarake, do të shkonim së bashku që ta shohim shtëpinë brenda se a bënë për t'i vu dushët e larjes aty brenda. Po planifikonin që të bëjnë aty dhe një lidhje telefonike civile që të mundë të përdorin personeli ushtarak, të kenë më lehtë kontaktin me familjet e tyre. Gjithashtu të bëjnë edhe një sallë ku do të vejnë një televizor që të lidhemi me botën e civilizuar me ngjarjet botërore, që të paktën të shohim se ç'po ndodhë edhe rreth nesh. Sot gjithashtu pritej që të kemi edhe vizitën e Gjeneralit Suprem Henry Shelton të Forcave të SHBA'së. Prej shtypit të vetmen gazetë që e kishim në bazë ishte gazeta ushtarake "The Stars And

Stripes", që në përgjithësi kishte shkrimet e jetës ushtarake, e cila shtypej edhe na vinte nga Bazat Amerikane në Gjermani. Por kjo gazette kishte edhe mjaftë informacine të shkurtëra dhe të përgjithëshme. Ajo që më interesonte më së tepërmi të lexoja apo ndëgjoja, ishin informacioni se si po zhvillohej dhe ishte gjendja mbrenda në Kosovë. Nga numri më i ri një i kësaj gazete, pashë se gjendja e Kosovës nuk ishte aspak e mire. Akoma po vazhdonte gjendja tragjike me popullin shqiptarë nga vrasjet, dhunimet, maltretimet, plaçkitjet dhe dëbimet prej armikut serb.

Në Bazën Ushtarake Amerikane të Rinasit, aty ku isha edhe unë tani kishim 24 Helikopterë Apache AH-64 të cilët për çdo ditë po bënin përgaditjet e tyre për ndërhyrje në Kosovë. Helikopterët Apache AH-64 ishin ndër helikopterët luftarak më të përsosur në botë, të cilët arrijnë shpejtësinë 227 mph (365 kmh) dhe ishin të armatosur me Stinger, AIM-9, miselsajer-ajër, raketat 70mm, guan 650 fishekë në minutë (që janë në gjendje të shpojnë edhe autobлиндat) etj. Kryesisht të specializuara për sulm mbi tanke dhe objektivat e ndryshme tokësore.

Gjatë mbrëmjes së sotme isha i ftuar që të merrja pjesë në mbledhjen e përditëshme të shtabit ushtarak në Rinas, ku ishin Gjenerali Joe Hendrix, koloneli dhe kapitenët nga të gjitha njësitë ushtarake që ishin në këtë bazë të Rinasit. Mbledhja ishte shumë informative. Pjesa e mbledhjes që më interesonte mua më së shumti ishte informacioni nga tereni dhe ndodhitë në Kosovë. Aty kuptova për përjashtimin e Drashkoviqit nga kabineti i Serbisë nga Millosheviqi. Kjo gjë më gëzoi sepse po mbetesh me shpresë se po kapeshin partitë serbe në mes veti. Mendoja se përçarja e tyre në mes veti do të ndikojë për më mirë në marrëveshje me palën serbe. Lajmi që më gëzoi më së shumti ishte biseda ku po bëhej plani i sulmit të këmbësorisë dhe artilerisë amerikane nga Shqipëria. Kjo pritej që të fillonte për mbrenda 2-3 ditësh pasi se Milosheviqi nuk e kishte ndërmend që të dorëzohet edhe pas të gjitha atyre rrenave dhe mashtrimeve të tij që i kishte premtuar Gjeneralit Suprem të NATO's Wesley Clark'ut. Aty u bisedua se nga 2 apo 3 maji 1999 do të jetë dita e sulmit dhe hyrjes së trupave të NATO's nga Shqipëria në Kosovë. Kjo do të ishte një ditë që po na afrohej, ishte një ditë që e kisha ëndërruar për shumë kohë dhe mezi po e prisja me pa durim. Nga këto pritje edhe stërzgjatje, edhe ushtarët amerikan tani ishin të gatshëm dhe shumë herë më thonin se: "Ne nuk kemi ardhë këtu në pushime, ne jemi këtu që të kryejmë punën tonë dhe të kthehemi andej prej nga kemi ardhur."

Informacionet e 24 orëve të fundit

Në mesin e objektiveve të NATO's sot ishin edhe autostradat, hekurudhat, urat, depot e karburantëve, fabrika e feronikilit në Kosovë, pikat kufitare, aeroportet, disa grupe të automjeteve ushtarake siç janë: kaqushat, tanket, tankerët e karburantëve mbrenda Kosovës, vendet e SA3 dhe SA6 SAM, transmetuesi kryesorë i Beogradit, Shtabi i Përgjithshëm Jugosllav, ndërtesa e Ministrisë Federale në



1 Qershor 1999 Kukës/Shqipëri, Unë me Njësinë Speciale të Armatës Amerikane me Gjeneralin Arbëresho-Amerikanin John W. Hendrix

Beograd, ndërtesat e policisë serbe si dhe depot e armëve. Me rritjen e caqeve të sulmit u rritë edhe agriviteti si nga mbrojtja ajrore serbe ashtu edhe nga raketë lancuesit tokë-ajër.

Sipas Pentagonit tani pritej që të fillojnë edhe bombardimet më së tepërmi me B-2. Mbrenda disa ditësh pritej që t'i shtohen forcave të NATO's edhe 28 aeroplane furnizues të karburanteve për aeroplanët sulmues që ishin në ajër...

E shtunë 1 maj 1999

Si çdo herë edhe sot në të zgjuar nga gjumi, shkuam dhe morëm ushqimin e mëngjesit, ishte ditë e bukur me diell dhe e ngrohtë. Pas ushqimit të mëngjesit isha caktuar që me kompaninë "Bravo" të dalim në teren për kalibrime të reja të Lancuesve Raketorë MLRS. Më vonë më njoftuan se planet e sodit kishin ndryshuar krejtësisht, dhe nuk dolëm askund. Meqenëse nuk isha i angazhuar askund, vendosa që të shkoj në mbrendësi të aeroportit të Rinasit dhe ta provoj telefonin përsëri mos po kam fat edhe të mundem të kontaktojë ndonjërin nga pjesëtarët e familjes time në shtëpi. Po, sepse u bë një kohë bukur e gjatë pa patur kurrëfarë kontakti. Hyra në kabinën e telefonit edhe provova disa herë, por kësaj here pata fatin e madh. Kësaj here nga ana tjetër u ndëgjua zëri i zemrës së jetës Shahadisë, e cila edhe ajo ishte bërë shumë merak. Ajo menjëherë m'u vërsul, se pse nuk e kisha telefonu gjerë më tani. Po mendonte se sikur të ishte faji im! I tregova se lidhjet telefonike janë shumë të dobëta, dhe thujse është e pa mundur apo tepër vështirë për ta marrë lidhjen. I tregova se si po kalonim, por kuptohet veçse gjëra të mira më positive. Asgjë nuk i tregova për kushtet miserablë që kishim në këtë bazë ushtarake, që edhe ajo të mendojnë se po kalojmë çaste të mira në këtë lloçin e bekuar të Rinasit! Kjo ishte biseda e parë që po bënim që nga fillimi qysh se erdha këtu në Shqipëri. Nga biseda kuptova se që të gjithë ishin mirë, dhe nuk kishte kurrëfarë ndryshimesh. Shahadija më njoftoi se sot në faqet e gazetës së përditëshme të Cleveland'it, "Plain Dealer" ishte botuar intervista ime nga gazetari i Associated Press, Doug Mellgren me titullin; "ALBANIAN-AMERICAN RESPONSE TO A CALL TO DUTY" ("SHQIPTARO-AMERIKANI I PËRGJIGJET THIRRJES SË "ATDHEUT") dhe gjithashtu me nëntitullin nga fjalët e mia "I OWE BOTH COUNTRY'S ALOT, TO ALBANIA AND THE UNITED STATES." ("I kam shumë borxh që të dy shteteve, Shqipërisë dhe SHBA'së"). Intervista ishte e zhvilluar disa ditë më herët me disa pika të shkurtëra, për jetën time dhe rrugën deri këtu në Kampin Ushtarak Amerikan të Rinasit. Pas bisedës telefonike u ktheva i gëzuar që pata kontaktin e parë në telefon me të dashurit e mi. Shkova drejtë në çadrën e Shtabit të Përgjithshëm Ushtarak në Rinas, ku pritej të fillonte edhe mbledhja e radhës me krerët e Shtabit të Përgjithshëm këtu në Rinas. Gjatë mbledhjes së shtabit ushtarak, u bisedua edhe për "Marrëveshjen Paqësore të Millosheviqit" që po e shqyrtonin, si dhe për lirimin e ushtarëve amerikan që ishin nuanë në kufirin e Maqedonisë Perëndimore. Ata ishin kapur diku

në afërsi të Kumanovës. Ajo marrëveshje më dukej disi e kotë sepse Millosheviqi deri më tani na kishte dhënë premtime të pa numërta. Ai kishte premtuar kinse do të ndërpresë sulmet, si dhe do të mirrej vesh me shqiptarët për një paqë të vërtetë etj!

U bisedua edhe për përparimin e forcave të UÇK's në fronte të luftës për rreth Junikut, dhe në disa pjesë të tjera të Kosovës. Në bazë të bisedës po shihej se si edhe aviacioni i NATO's me bombardimet e tyre kishin filluar të kenë efektin e tyre në luftën kundër forcave paramilitaro-ushtarake serbe. Gjatë mbledhjes u bisedua se tani nga sukseset e bombardimeve të NATO's mbi forcat serbe, i paska kapë frika dhe demoralizimi i ushtarëve se kjo luftë atyre nuk do t'i sjellë asgjë tjetër përveçse humbjeve në ushtarë dhe material luftarak. Gjithashtu aty po bëhej fjalë edhe po bëheshin planifikimet e fundit që me 3 Maj 1999 të fillojë sulmi. Sulmi pikë së pari do të kryhej me raketat MLRS që i kishim në dispozicione, ku me raketat e tilla do të arrinin caqet deri në 180 milja (290 km) largësi, sepse deri më tani kishin pasë në dispozicion vetëm raketat që do të arrinin caqet deri në 90 Milja (145km). Poashtu edhe numri ushtarëve dhe mjeteve tjera ushtarake ishte rritë dukshëm në Bazën e Forcave Amerikane të Rinasit. Morali ushtarak në forcat amerikane ishte shumë i lartë, dhe kishin mendimin se pas dhënies së urdhërit për sulm, shumë shpejtë do të mposhtnin dhe shpartallonin forcat serbe, edhe atë mbrenda një kohe shumë të shkurtër! Thuhej se sulmi i parë do të fillojë nga njësitë e artilerisë të Raketë Lancuesëve MLRS me të cilat isha edhe unë, ku menjëherë pas tyre do të vazhdonin edhe me sulmet nga helikopterët Apache AH-64, që kishin kapacitetin të shkatërrojnë gjithëçka që do t'i paraqitej nga forcat serbe. Ky do të ishte sulm i pa imagjinueshëm. Gjatë bisedave me shtabin, ishim mjaftë të hapur në bisedë. E dinin shumë mirë mllëfin tim ndaj forcave serbe, edhe gjatë bisedës më premtuan se gjatë sulmit të parë edhe unë do të isha pjesëmarrës me to. Ata më premtuan pasi se më konsideronin dhe respektonin sikurëse të isha një ushtarak i vjetër me to! Tani mezi po prisja ditën e 3 Majit e cila ditë do të jetë dita më e dashur e imja, sepse me të do të fillonte sulmi që do të drejtohej edhe prej Shqipërisë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme, ishte sulmi i NATO's drejtë autobusit i cili po kalonte mbi urën në Luzanë në veri të Prishtinës, e cila ishte nyja kryesore për furnizimin e ushtrisë jugosllave si dhe për furnizime të policisë speciale në Kosovë. Sipas informatave serbe thuhet se nga ky sulm mbetën të vrarë 40-60 vetë. Gazetarët e pavarur raportuan se ishin të vrarë rreth 15 persona. NATO tha se arma ishte lëshuar për të bombarduar urën, ku fatkeqësisht në të njëjtën kohë kur po bombardohej kaloi autobusi i cili u kap nga sulmi.

Injejt incident kishte ndodhë edhe njëherë tjetër, për derisa po kryhej sulmi në një urë hekurudhore kalon treni dhe kapet në të njëjtën mënyrë. Sot gjithashtu ndodhi edhe një aksident me një Aeroplan AAV-8B Harrier të Marinës Amerikane i cili ra në ujërat e Adriatikut për



7 Qershor 1999 Foto që shkrepë diku afër kufirit Shqipëri/Kosovë, gjatë bombardimeve të B52 Amerikane / NATO's Brenda Kosove

derisa po kthehej nga manovra në anije mbajtëse. Nga ky aksident piloti i aeroplanit u shpëtua. Gjatë ditës së sotme prej SHBA's arritën në Angli edhe 10 bombardues B-52 të USAF...

E diel 2 maj 1999

Sot në orën 6:30 në mëngjes, erdhi Kapiteni Bernodini më mori që të dalim përsëri me Lancuesit Raketor MLRS në pikat strategjike, për të bërë kalibrimet e zakonshme. Gjatë rrugës nga lancuesit raketor dhe automjetet tjera ushtarake, po ngrihej pluhur aq i madhë saqë pas një kohe nga ky pluhur i madhë që të gjithë po dukeshim sikur të ishim mullinjëxhinjë, ashtu siç i mbulon mielli ata gjatë punës së tyre. Në konvojim tonë kishim 12 automjete ushtarake (humvees, kamiona, autobinda dhe MLRS), ata që ishin prapa nesh nuk mundë të shihnin thujse asgjë nga pluhuri që po ngrihej nga automjetet para tyre. Në vendin e caktuar ku vajtëm, gjetëm edhe disa lancuesit raketor të tjerë që kishin shkuar më herët, e që ishin në fazat finale të kalibrimit për hapjen e zjarrit. Aty i gjetëm teknikët ushtarak të Lancuesve Raketor MLRS që ende ishin në gjumë, sigurisht nga puna gjatë natës së më parme. Pasi mbërrijmë aty, ushtarakët që nuk ishin në roje filluan të zgjohen dhe mbetën të habitur nga kolona jonë që po i afrohem. Më vonë vazhduam rrugën edhe për në caqet tjera që ishin vendosë diku në kodrinat përtej Fushë Krujës. Lu ngjitem edhe një kodrinë të lartë pa rrugë dhe mjaftë të pjerrët, në këtë rrugë aty pashë aftësitë dhe vlerën e këtyre makinave ushtarake Hamvee, të pajisuna me armë e mitraloz .50ml.mbi to, të cilat po i ngjiteshin kodrinës përpjetë pa kurrëfarë problemi. Pasi arritëm mu në majë të kodrës stopuam dhe të gjithë dolëm jashtë prej Hamvee's. Të gjithë ndoshta nga rruga e gjatë filluan të urinojnë, dhe pastaj filluam të shijojmë të gjitha ato bukuritë natyrore që po na rrethonin nga të tëra anët për rreth nesh. Ishte një panoramë e bukur dhe shumë piktureske, të cilën e regjistruan shumica e ushtarëve në fotoaparatat e tyre. Në një anë kishim majat e maleve dhe fushave ndërmjet tyre, kurse në anën tjetër të majës së malit kishim pamjen tjetër larg në horizont ku shihej një

pamje mahnitëse e detit Adriatik. Pas pauzës që bëmë në majat e malit përsëri filluam të zbresim te poshtë nga maja e malit. Gjatë rrugës te poshtë iu drejtova kapitenit dhe e pyeta se: "Me çfarë qëllimi na solle kaq lartë kapiten, a vetëm për të urinur?" Që të gjithë që ishim mbrenda automjetit ia plasëm gazit, por edhe ai po qeshej në zë dhe i cili mu drejtua duke më thënë: "Shumë me vend e ke, po erdhëm të urinojmë në këtë majë të lartë të malit, por edhe sa për të tregu ty sa e bukur që është Shqipëria. Pata dëshirë të madhe që të vijmë edhe të shijojmë dhe këto bukuritë natyrore që po na rrethojnë, por para së gjithash dihet se detyra jonë kryesore është edhe gjetja e pikave kryesore edhe më strategjike. Ky ishte vendi prej ku do të përqëndroheshin radio-lidhjet kryesore, prej ku do të bëhet koordinimi i pikave strategjike dhe prej ku do të fillojmë sulmin". Gjithashtu e pyeta se a e din se a do të fillojmë sulmin sonte? Ai mu përgjigj: "Sa për momentin nuk dihet, ashtu ka qenë plani, mirëpo siç po shihet tani edhe kryetari i SHBA'së Bill Clinton po planifikon që me 5 Maj (1999) të na bëjë një vizitë. Nga shkaku i vizitës së tij ndoshta do të shtyhet edhe dita e sulmit, por ende nuk jemi të sigurtë"! Ky ishte një lajm shumë dëshpërues për mua, po edhe për pjesëtarët tjerë ushtarak. Pas disa orësh bredhjeve nëpër bjeshkët përtej Fushë Krujës përsëri u kthyem në bazën ushtarake të Rinasit.

Gjatë mbrëmjes në mbledhjen e shtabit të përgjithshëm, përsëri u bë fjalë për lirimin e 3 ushtarëve amerikan të kidnapuar diku në afërsi të kufirit të Kumanovës në Maqedoninë Perëndimore. Kjo po bëhej me ndërmjetësimin e aktivistit me ngjyrë të SHBA'së Jesse Jackson, i cili para disa vitesh kishte kandiduar edhe për President të SHBA'së. Ky ishte një shok i aktivistit të njohur amerikan Martin Luther Kingut. Aty u bisedua se tani në bazën e Rinasit kishim në dispozicion 27 Lancues Raketor MLRS. U fol se bombardimi do të fillojë me 12 Lancuesit e Raketave MLRS pa ndërprerje përderisa të bëhet gati 12'tëshi tjetër dhe kështu me rradhë, kurse 3 Lancues Raketash MLRS do të mbeten në rezervë. Nëse ndonjëri do të kishte ndonjë defekt teknik, njëri nga

rezervat do ta zvendësonte derisa të rregullohet ai. Gjatë mbledhjes u tha se në mbrendësi të Kosovës gjatë këtyre ditëve nga forcat serbe qenkan përdorë edhe armë kimike! Mua më thanë se tani duhet shkuar dhe të fillojmë përgaditjet për nisje të hershme, menjëherë aty nga ora 4:00 e mëngjesit të ardhshëm me kompaninë "Charlie".

Informacionet e 24 orëve të fundit

Herët në mëngjesin e sotëm 7 raketa të NATO's kishin qëlluar rafinerinë e naftës në Novi Sad. U raportua edhe për gjujtet e mëdha anti-ajrore për rreth bregdetit të Malit të Zi. Disa eksplozime ishin ndëgjuar në rajonin e bregut të Kotorit kur po fluturonin eroplanët e aleancës mbi këtë rajon, të cilët po vinin nga bazat e aviacionit në Itali. Sot gjithashtu u sulmua edhe komanda e kontrollit ushtarak në afërsi të Beogradit, antena e radio-transmetuesit, depo karburanti, urat, si dhe aeroporti i Nishit. Aleanca e NATO's gjithashtu sulmoi edhe auto blindat, pozicionet e mortajave, postet komanduese, artilerinë, 6 raketancuesit tokë-ajër si dhe automjetet për kontrollin ajrorë. Sot edhe një Aeroplan Amerikan F-16 CG u rrëzua afër Meticit, rreth 18 Km. në lindje të vendit të quajtur Kozluk në Serbinë perëndimore. Pas dy orësh piloti amerikan u shpëtua nga njësitë ushtarak amerikan.

Gjatë ditës së sotme pati bombardime edhe mbi kazermën ushtarake jugosllave në Sremska Mitrovicë të Vojvodinës. Gjithashtu sot u bombardua edhe stacioni policor dhe fabrika e asfaltit "Kosmet put" në Mitrovicën e Kosovës...

E hënë 3 maj 1999

Ashtu siç më porositen aty para orës 4:00 të mëngjesit erdhi kapiteni që të më zgjojë, edhe pse thujse nuk kisha fjetë aspak nga gëzimi, sepse e dija se për ku po niseshim. Ishte ende natë, mirëpo kishim një mot të kthjellët dhe me shumë yje. Gjithashtu kishte një shkëlqim të mrekullueshëm të hënës, po dukej sikur të ishte ditë. Si zakonisht edhe sot u nisëm në kohë të saktë, rrafsh në orën 4:00 të mëngjesit. Kësaj here me ne kishim edhe 5 Lancues

Raketash MLRS. Sot pasi arritëm atje lartë, tani duhej të kalibroheshin për objektivat e rinjë të sulmit kundër serbisë. Nuk shkuam aq largë nga baza ushtarake e Rinasit, ndoshta rreth 10 milja (17 km) largësi. Gjatë daljes hasëm në vështirësi, pasi se në hyrjen kryesore të bazës dyert e hyrje daljes kishin qenë të mbyllura me dry për sigurinë e ushtrisë. Aty u vonuam disa minuta për derisa gjetëm çelësat me ndërmjetësimin e ushtarëve shqiptarë të cilët ishin aty në roje. Për fat ata e kishin ditur se kush po mbante çelësat, cili nga oficerët e ushtrisë amerikane. Pasi dolëm jashtë bazës e bëmë një rrugë disa kilometrash largë bazës me 5 Lancuesit Raketor MLRS, të cilët dikur u ndalën dhe bënë kalibrimin me sukses. Njëri prej tyre kishte problem teknik dhe nuk mundi të kalibrohet. Pas disa orësh munda, më në fund vendosën që ta lënë për në herën tjetër, sepse problemi nuk po rregullohej shkaku i defektit të një pjese që po mungonte dhe të cilën nuk e kishin me vete. Në çdo vend që shkonim, si spektator të pare që kishim ishin fëmijët kurrshtar. Ata dëshironin të na shohin se ç'po bënim, dhe shpeshherë i shpërblenin me ndonjë sheqerë që na qëllonte. Më vonë na ofroheshin edhe burrat më të vjetër, por nga burrëria e tyre e mbanin veten sikurse nuk donin të dinin se ç'bënim. Gjatë kësaj here për derisa qëndronin në distancë 10-20 metrash, na u afrua një plak me shtat i vogël dhe me plis. Ai me vete aty afër kishte disa lopë dhe dele për të cilët po kujdesej në kullotën për rreth nesh, i cili disi i habitur deshti të dijë se ç'po bënim?! Unë iu afrova ngadalë dhe e përshëndeta në shqip me: "Tungjatjeta axhë!" Kur më ndëgjoi plaku se po i flisja shqip dhe isha me uniformë ushtarake amerikane, nuk ngurroi aspak edhe mu afrua edhe më afër edhe më tha: "Të lutem më lejo që të përqafoj o djal i jonë!" U përqafova si me u pasë njohur për një kohë të gjatë dhe filloi me zë të ulët të më thotë në vesh: "Unë erdha këtu nga rrethi i Kukësit, dhe që ja këtu po merrem me ruajtjen e bagëtisë". Meqenëse isha i lirë sepse ushtarakët ishin të nxanun me punën e tyre rreth Lancuesit Raketor MLRS dhe nuk kisha punë, filluam bisedën me

plakun Kuksjan edhe për disa minuta. Ai erdhi edhe më afër edhe vazhdoi duke më thënë: "Eh more djalë, pasi se ti po dinë shqip, shiko çka po të them: ne nuk jemi shqiptarë me të thanë të drejtën siç ishin ato të parët tone. Ne jemi meleza a po më kupton? Ne po të kishim qenë shqiptarë të vërtetë, edhe ne sot do të ishim në vijën e parë të frontit. Të gjithë së bashku do të ishim për t'i ndihmuar vëllezërit tanë shqiptarë atje në Kosovë. Po atje ku po e luftojnë serbinë, e jo vetëmse me u hangër me llafe me njëri tjetrin. Shyqyr që keni ardhë ju amerikanët këtu...", unë i ndërhyra, edhe pse disa herë më herët i tërhoqa vërejtjen dhe i kisha tregu se edhe unë isha shqiptar, por jetoj në Amerikë një kohë të gjatë. I tregova, por nga uniforma ushtarake atij nuk i besohej se isha shqiptar. Ai vazhdoi edhe më tej sikur nuk më ndëgjonte: "E ishalla sa më shpejtë e kryeni me serbët ju amerikanët, se e jona e ka pasë moti kohë, se ne nuk kemi as shtet e as bythë për t'i ndihmuar vëllezërit tanë!" Ne ishim thelluar në bisedë me plakun i cili ishte shumë i dashur dhe po më hiqte mërzinë mua, sepse moti kohë nuk isha parë apo ndëgjuar edhe me më të afërmit e mi nga trojet shqiptare të Jugosllavisë, prej ku kisha ikë para shumë vitesh. Për derisa ishim të përqaftuar me plakun, aty afër na u kishin afruar edhe një grup prej 5-6 gazetarë dhe fotoreporterë ndërkombëtarë, ku ata po shkrepnin fotografi me neve të përqaftuar gjatë bisedës! Këta gazetarë dhe fotoreporterë që ishin aty, kishin ardhë nga e gjithë bota, të cilët tani po përcillnin gati se të gjitha lëvizjet tona që po bënim. Po ishin afruar për të na parë prej së afërmi se ç'po ndodhë. Edhe gazetarët dhe fotoreporterët u habitën kur na panë se si unë nga ushtria amerikane po bisedonim me plakun shqiptarë në gjuhën shqipe. Ata kishin pare edhe kontrastin e bukur: unë me uniformë ushtarake amerikane, ndërsa plaku me plisin mbi kokë. Nga të gjitha drejtimet ende po vazhdonin me shkrepjen e fotografive të fotoaparateve të tyre. Ata po fotografonin plakun e përqaftuar me mua, i cili më mbante për qafe sikur të isha i biri i tij. Pas disa minutash i pyeta gazetarët se

prej nga dhe kush ishin? Filluan të më përgjigjen, njëri më tha se ishte fotoreporter i "Associated Press", tjetri më tha se ishte nga "Detroit Free Press", tjetri ishte nga Zelanda e Re, e një tjetër nga një media e Australisë edhe një tjetër më tha se ishte nga Televizioni Polak, të cilët na u faleminderuan që pranuan të fotografohemi së bashku me plakun e dashur!

Ky rast para foto reporterve për një moment ma përkujtoi kohën time kur para shumë vitesh isha angazhuar si fotomodel, gjatë viteve '80, në kohën kur posa kisha ardhë dhe gjatë fillimit tim në Amerikë. Fotoreporteve iu dukë si skenë interesante. Një plak shqiptar me plisin tradicional së bashku me personin me helmët dhe uniformën e ushtrisë amerikane. Ne në të vërtetë që të dy ishim të një gjaku, atij të gjakut Arbërorë dhe pse politika na kishte ndarë!

Shpeshherë plaku më thonte: "Dhe jani sa më shpejtë serbit, se atyre duhet treguar se çka është forca e vërtetë, sepse ne kemi mbetë për askund, edhe as për vetëveten siç po na shihni edhe ju vetë. Njëherë Enveri, mbas andej edhe këto partitë që luftojnë për karrige, masandej piramidat e kursimit, e më në fund kur ta shohësh prej neve s'ka asgjë!" Pas një kohe bukur të gjatë bisede, më në fund erdhi koha që të ndahemi sepse kolegët ushtarak më thanë se po ktheheshim në bazë.

Tani kur po e shkruaja këtë ditar, sa më erdhi lajmi se duhet të bëhemi gati, duhet t'i mbledhë të gjitha plaçkat e mia, se sonte rreth orës 1:30 pas mesnate në shoqërinë e Kapitenit Berdonini dhe kompaninë "Charlie" do të shkojmë në teren diku largë për 4-5 netë. Më thanë se gjatë kësaj kohe sigurisht se do t'ia dhezimis edhe serbisë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sipas informatave gjatë ditës së sotme forcat aleate të NATO's sulmuan rajonin e Savine Vode në veriperëndim të Kosovës, ku thuhet se u qëllua një autobus i "Djakovica Prevoz" që po udhëtonte ne relacionin e njëjtë Pejë-Rozhajë bashkë me një makinë udhëtarësh, diçka që u demantua nga NATO'ja, dhe askundë nuk mundën të gjejnë

informata për këtë incident...

E martë, 4 maj 1999

Aty rreth orës 1:30 pas mesnate u nisëm nga kampi ushtarak në Rinas, ishte një natë jo e ftohtë. Hëna ndriçonte dhe shihej jashtë për mrekulli. Si zakonisht u nisëm një konvoj i gjatë automjetesh ushtarake, por kësaj here ishim shumë më tepër se sa herave të tjera. Në këtë kolonë ushtarake kishim edhe 12 Lancues Raketash MLRS. Shkuam të njëjtës rrugë si shumë herë më parë, duke kaluar përmes Fushë Krujës, pastaj vazhduam rrugën për rreth një fabrike të madhe të cimentos që ishte jashtë përdorimit dhe dolëm në një kodrinë përtej Fushë Krujës. Dolëm në një rrafshnaltë kodrinore afër fshatit Patok. Arritja deri në vendin e caktuar ishte mjaftë interesante. Në ç'udhëkryq kishim mbrojtjen nga ushtarakët e forcave tona amerikane që na jepnin sinjale me dritë të kuqe për vazhdimin e udhëtimit të mëtejme, derisa u afruam disa kilometra afër cakut të arritjes. Pastaj, secili automjet fiku të gjitha dritat edhe ashtu nëpër terr me përdorimin e dylbive të natës (night vision binoculars) vazhduam edhe për disa kilometra derisa arritëm në një lëndinë lartë në kodrinë. Aty secili nga automjetet zuri pozicionin e tyre. Shkuam atje ku ishte një qetësi e jashtëzakonshme dhe s'dëgjohej asgjë! Aty kaluam natën dhe qëndruam deri në mbrëmjen tjetër. Ditën e kaluam më tepër sikurse me pasë dalë në piknik: kishim haje, piqe, shaka dhe gjumë sa të duash. Neve kësaj here na shoqëronin edhe mediat ndërkombëtare si: gazetarët e "Associated Press", fotografisti i "USA Today" dhe një ekipë televizive e televizionit amerikan "ABC" me gazetarin e mirënjohur Ted Kopel, të emisionit "Nightline". I tërë akcioni udhëhiqej nga Kapiteni Bernardoni të cilin e shoqëroja unë. Edhe kjo ditë ishte e bukur me diell e cila kaloi shpejtë. Ne tanimë po prisnim natën finale, ishte nata e shumëpritur për shumë kohë gjerë më tani. Që të gjithë ishin të gatshëm dhe mezi po prisnin që t'i tregojnë Serbisë forcën amerikane. Po, serbëve që luftonin njerëzit e pa armatosur në Kosovë. Tani kishte filluar të errësohet, isha me kapitenin Bernardoni dhe shoferin në makinë, ku nëpërmjet të radio-lidhjeve që kishim në Humvee ndëgjuaam urdhërin nga shtabi i përgjithshëm në Rinas. Ata na urdhëruan që të jemi të gatshëm për sonte që të fillojmë goditjen në orën 1:01 pas mesnate mbi forcat serbe! Nga lajmi i marrë i gjithë personeli ushtarak ndiheshin shumë të gëzuar, por përsëri nuk ma mirte mendja se ndonjëri prej tyre ishte më i gëzuar se unë! Dikur gjatë ndejës si në shaka i thashë Kapitenit Bernardoni: "A bënë që unë ta dhezi raketën e parë?" "Po, si jo" ma ktheu në hajgare." Ty të kanë ushtuar në bazën ushtarake të Fort Benning për 15 minuta se si ta përdorësh maskën e gazit, edhe ne po të ushtrojmë nja 20 minuta këtu, edhe ti mere përsipër komandën edhe kryeje punën e karrierës tonë ushtarake!" Shumica e ushtarëve të ulur nëpër automjetet e tyre tani i kishte zënë gjumi si me qenë në piknik në natyrë të hapur. Në automjetin ku ishim të ulur ne, në karriget e përparme ishte vozitësi ushtarak i cili quhej Rowlan dhe kapiteni Bernardoni kurse në

karrigën mbrapa qëndroja unë i vetëm. Me vonë kapiteni nxorri një orë me alarm edhe e vari në dritare. Gjatë kësaj qetësie të errët siç duket edhe mua gati se më kaploi gjumi, kurse vozitësi dhe kapiteni veçese ishin në gjumë sepse ndëgjohej gërhatja e tyre. Fillova të mendoj se si të veprojmë, sepse këta i kishte zënë gjumi. A t'i zgjojë apo të presë derisa të zgjohen vetë. E pashë se dikush po afrohej i cili erdhi deri afër dhe m'u afrua mua, ishte gazetari Daug Mellgreni "Associated Press". Ishte cimeri im i cili më kishte intervistuar para disa ditësh, kishte ardhë dhe donte të merrte lajmet më të hollësishme nga unë. Erdhi sepse tani njëfishim dhe ishim së bashku në të njëjtën çadër, edhe më njëhte shumë mirë se unë isha brenda burimit të lajmeve. Ai e dinte se unë isha prezentë edhe në mbledhjet e komandës ushtarake dhe nuk mbanin ndonjë fshehtësi prej meje. E kishin informacionin pararaq se sonte do të ndodhë diçka e madhe dhe me rëndësi, sepse tani edhe transmetimet direkte të televizionit të ABC jepeshin kohë pas kohe për audiencën Amerikane. Ishin të gatshme për transmetim me kamerat dhe të gjithë ekipën e tyre të drejtuar drejt Lancuesve Raketor MLRS.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme u dha lajmi edhe për aksidentin e helikopterit Apache, ku humbën jetën dy pilotët amerikan, e që shënon viktimat e para ushtarake në Operacionin e Forcave Aleate të NATO's. Sulmet edhe sot kishin vazhduar rreth zonës kufitare me Shqipërinë, si dhe disa caqe ishin qëlluar në mbrendësi të Serbisë. Gjatë mbrëmjes forcat e NATO's qëlluan caqe mbrenda Jugosllavisë, po ashtu qëlluan edhe Brigadën 125 të motorizuar në veri të Kosovës, Brigadën 233 në lindje të Kosovës, duke qëlluar një numër të autoblandave si dhe pozicionet e artilerisë, automjetet ushtarake, postin e komandës, 2 radar si dhe automjetin me raketa tokë-ajër. Sot u sulmua edhe kazerma ushtarake në Vranjë, ura dhe objekti riparues në Kacaç, gjithashtu u qëllua edhe fabrika e përpunimit të derivateve të karburantit në Novi Sad. Në Batajnicë shkatëruan aeroplanët e fundit MiG 29 dhe 2 aeroplanë të tjerë...

E mërkurë 5 maj 1999

Pasi se kaloi mesnata, shumica e ushtarakëve gjithashtu edhe kolegët e mi kapiteni dhe vozitësi, po dhe shumica e të tjerëve për rreth meje ende ishin në gjumë. Sot ishte edhe ditëlindja e shoqes së jetës time Shahadijes, kisha dëshirë shumë të madhe që t'ia uroja. Të paktën dëshiroja ta merrja në telefon që të isha i pari për t'ia uruar ditëlindjen, por edhe me e festu lirinë e Kosovës e cila tani nuk ishte aq large. Do të afrohej shumë shpejtë liria pas akcionit që do të ndërmerrim! Po presim tani që të fillojë festa më e madhe e jetës, sulmi mbi forcat serbe, si dhe festimi i ditëlindjes së Shahadijes. Në vend të fishekzjarreve, kësaj here do ta festojmë me raketa që do t'i djegin prapanicën serbisë. Do të jetë festë e dyfishtë dhe më madhështore për ne.



1999 Foto e Pentagonit pas bombardimit të kazermës ushtarake serbe në Prizren /Kosovë



Veton Zymberi, redaktor i sportit

FEK-ja ia lë fajin Kosovës: I papranueshëm përdorimi i sportit për agenda politike

PRISHTINË, 27 MARS - Federata Evropiane e Karatesë e ka fajësuar Qeverinë e Kosovës për mospjesëmarrjen e karateistëve kosovarë në Kampionatin Evropian që po mbahet në Spanjë. Sipas FEK-së, përdorimi i sportit për agenda politike është i

papranueshëm. "FEK bëri të pamundurën për të siguruar që garuesit nga Kosova të kishin kushtet më të mira për të marrë pjesë në ngjarjen në Guadalajara ashtu si bëmë me pjesën tjetër të 48 delegacioneve nga e gjithë Evropa që morën pjesë në

ngjarje", ka thënë Espinos për "insidethgames". Mirëpo, nga përfaqësueset e delegacionit të Kosovës jemi njoftuar se janë udhëzuar nga qeveria e tyre të heqin dorë nga pjesëmarrja në ngjarje pasi kishin arritur këtu dhe ishin në Guadalajara me pjesën tjetër të delegacioneve

pjesëmarrëse në kampionat. Ne e konsiderojmë të papranueshëm përdorimin e sportit për agjendat politike dhe shpresojmë që sportistët të mund ta ushtrojnë sportin e tyre pa ndonjë formë të presionit politik nga qeveritë e tyre".



'Dardanët' kërkojnë fitoren e parë në rrugën drejt 'Euro 2024'

PRISHTINË, 27 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës e ka mbajtur stërvitjen e fundit para përballjes kundër Andorrës. Kjo ndeshje zhvillohet sot (e martën) në orën 20:45, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Atmosfera në radhët e "dardanëve" para këtij dueli është shumë e mirë dhe të gjithë futbollistët janë të gatshëm për të dhënë maksimumin për ta shijuar fitoren e parë në rrugën drejt realizimit të objektivit madhor – kualifikimit në Evropian. Pas arkëtimit të një pike të rëndësishme si mysafirë në Tel Aviv kundër Izraelit, Përfaqësuesja e Kosovës rikthehet para tifozëve "dardanë", e gatshme për të dhuruar emocion e spektakël, por edhe për të arkëtuar tri pikët e plota. Në konferencën

për media janë paraqitur përzgjedhësi, Alain Giresse dhe sulmuesi Vedat Muriqi. Giresse ka thënë se ekipi i tij vjen në këtë sfidë i motivuar dhe pa asnjë nënçmim ndaj rivalit, por me synim të qartë. "Vijmë nga një rezultat pozitiv dhe do të bëjmë përpjekje që ta ruajmë këtë ecuri pozitive me fitore ndaj Andorrës. Pikën e fituar në Izrael mund ta vlerësoj pozitive, edhe pse kemi mundur ta fitojmë krejt ndeshjen. Andorra autsjader i grupit? Ne nuk e neglizhojmë aspak dhe as nuk e konsiderojmë të dobët. Në këtë garë duhet të tregojmë seriozitet maksimal në çdo ndeshje", ka theksuar Giresse. I pyetur për zhvillimet e fundit në federatë dhe nëse ka ndikuar kjo gjendje te ekipi ai ka thënë se ai është këtu për ta



përgatitur ekipin sa më mirë për lojë dhe jo të merret me çështje tjera. Ndërkaq, sulmuesi "dardan", Vedat Muriqi ka thënë se kundër Andorrës hyjnë me të vetmin qëllim – fitoren. "Pa e nënçmuar aspak kundërshtarin, në këtë ndeshje nuk mund ta mendoj dot një rezultat tjetër përveç fitores. Nëse duam të kualifikohemi në

Evropian atëherë duhet ta fitojmë patjetër këtë ndeshje", ka theksuar Muriqi.

Shqipëria nis kualifikueset e 'Euro 2024' me humbje

Shqipëria pësoi humbje nga Polonia me rezultat 1-0 në ndeshjen e parë të fazës eliminatore për "Euro 2024".

Shqipëria e nisi më mirë, duke krijuar raste para portës së polakëve. Sokol Cikalleshi ka goditur rrezikshëm në minutën e 22-të, por portieri polak ishte i vëmendshëm. Polakët nuk kanë rrezikuar shumë, ndërsa nga një gjysmërastr shënuan golin. Karol Shwidzki shënoi në minutën e 41-të, pas një topi të kthyer nga shtylla. Kuqezinjtë e nisën shumë mirë pjesën e dytë, duke rrezikuar me Myrto Uzuni dhe Kristjan Asllanin, por gjuajtjet e tyre u ndalen nga Wojciech Szczesny. Pas tyre kishte rast Lewandowski, por gjuajtja e tij u ndal nga Mihaj që ishte në vijë të portës. Në anën tjetër Shqipëria krejt në fund ka mundur të barazojë shifrat, por që Uzuni nga afër nuk qëlloi portë. Shqipëria i nis me humbje eliminatorët për "Euro 2024".

KOK-u i dërgon mundësit në rehabilitim pas traumave të pësuar nga tërmeti në Turqi



PRISHTINË, 27 MARS - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës, nën udhëheqjen e presidentit Ismet Krasniqi, ka mbajtur mbledhjen e 24-t, në të cilën janë shqyrtuar pika të ndryshme të rendit të ditës. Temë kryesore e diskutimit ishte Asambleja e Punës, e cila mbahet më 31 mars në "Hotel Emerald" në Prishtinë. BE konstatoi se të gjitha

përgatitjet po shkojnë sipas dinamikës së paraparë. "BE vendosi t'i mbështesë mundësit e rinj me dërgimin në një kamp rehabilitimi pas traumave të pësuar gjatë tërmetit në Turqi. Mundësit ndodheshin në Kahramanarash për një turne ndërkombëtar", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Po ashtu, u verifikua edhe një

herë lista e bursistëve "Shpresa Olimpikë 2023". Ata do të nënshkruajnë kontrata në një ceremoni që do të organizohet nga KOK-u. U diskutua edhe numri i mundshëm i pjesëmarrjes së sportistëve në Lojërat Evropiane Krakov dhe Malopolska 2023 të cilat mbahen prej 21 qershorit deri më 2 korrik 2023.

Tate, MVP i javës në Superligë

PEJË, 27 MARS - Në fundjavë u zhvillua xhiroja e 27 e Prince Caffè Superligës apo e parafundit për garat e rregullta në elitë. Basketbollisti me indeksin më të lartë në këtë xhiro ishte Jalen Tate i Pejës. Tate kishte indeksin 31, ndërsa ndaj Bashkimit për 29 minuta shënoi

23 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime. Ai ishte ndër më meritoret që "verdhezinjtë" realizuan fitoren e shtatë radhazi në elitë. Vëllaznimi shënoi fitoren më të rëndësishme këtë edicion, duke mundur Ponte Prizrenin dhe siguroi pjesëmarrjen në "play-

off" nga vendi i gjashtë. Më të mirët te kuqezinjtë ishin Damonte Dodd me 15 pikë, 17 kërcime e pesë asistime dhe Jordan Harris me 24 pikë, katër kërcime dhe gjashtë asistime. Trepça fitoi derbin e kësaj xhiroje, ku mundi Golden Eagle Yllin, ndërsa më i dalluari ishte

Drilon Hajrizi me 15 pikë, dhjetë kërcime dhe dy asistime. Ndërkohë, Sigal Prishtina shënoi fitore ndaj Rahovecit, për ta vazhduar serinë pozitive në elitë, kurse lojtari më i dalluar në parket te prishtinasit ishte Nate Grimes me 18 pikë, dhjetë kërcime dhe tri asistime.



Mercedesi për Hamiltonin: Nëse gjen një makinë që i jep titullin mund të largohet

STUTTGART, 27 MARS - Kohët e fundit po qarkullojnë zërat për një shkëmbim pilotësh në Formula 1 në mes të Charles Leclercit dhe Lewis Hamiltonit. I pari deklaroi se nuk ka ndër mend të largohet nga Ferrari, ndërsa i dyti për momentin ka heshtur. Ai që ka folur është shefi i

Mercedesit, Toto Wolff, që ka befasuar me deklaratën e tij, duke lënë të kuptosh se piloti britanik mund të largohet në fund të sezonit, kur skadon kontrata. "Unë nuk e di se çfarë bëhet me të ardhmen e të tjerëve. Unë di vetëm se ku jemi me Lewisin dhe Georgen dhe ku është

Mercedesi këtë sezon. Ne jemi ende duke analizuar situatën dhe duke parë se si mund të jetë e ardhmja, të bindur se Lewisi mund të firmosë sërish rinovimin me Mercedesin", ka thënë Wolff. "Nuk mendoj se Hamiltoni do të largohet nga Mercedesi në këtë moment të karrierës

së tij, por nëse ne nuk i ofrojmë dot një makinë të shpejtë dhe fituese, është e drejta e tij të shohë për një alternativë më të mirë. Është një pilot që dëshiron të fitojë sërish titullin dhe nëse arrin të gjejë një makinë që ia ofron këtë gjë, mund të largohet", u shpreh Toto



Familja Schumacher do të zhvendoset në Mallorca, rehabilitimi i legjendës së F1 do të vazhdojë atje

MALORCA, 27 MARS - Michael Schumacher është duke lëvizur nga Zvicra në Mallorca me familje për ta vazhduar rehabilitimin atje me ndihmën e ekipit mjekësor. Sipas medieve spanjolle, këtë vendim e ka marrë partnerja e tij, Corina Schumacher, e cila i ka qëndruar pranë që nga aksidenti. Që nga dhjetori i vitit 2013 piloti 54-vjeçar gjerman i Formula 1, shtatë herë kampion bote, ka qenë në koma pasi pësoi një lëndim të rëndë në tru. Piloti gjerman i garave me makina u fut në koma të shkaktuar dhe më vonë u dërgua në shtëpinë e familjes në Liqenin e Gjenevës, ku Corina po kujdeset për të me ndihmën e një ekipi mjekësor. Faqja e internetit



"mallorcadaily" raporton se dëshira e Corina është të zhvendoset në "Villa Jasmine", me vlerë 30 milionë euro, e cila do të përshtatet në mënyrë të tillë që t'i

plotësojë nevojat mjekësore të bashkëshortit të saj. Ndoshta kjo zhvendosje do t'i bëjë mirë edhe saj pasi Corina ka jetuar gjithë këtë kohë si një "e burgosur".

Bostoni nuk dorëzohet për kreun në Lindje, rikthim me humbje për LeBron

BOSTON, 27 MARS - Bostoni fitoi me lehtësi 137-93 ndaj San Antonios, duke vijuar sfidën me Bucksin për kreun e renditjes në Lindje. Për Celticsin u dallua Browni me 41 pikë e 13 rebounde. Rikthim me humbje për LeBron Jamesin pas gati një muaji pushim. Lakersat u mundën me rezultat 118-108 nga Chicago. Më i miri për Bulls-in ishte Zach LaVine me 32 pikë. Humbja e katërt radhazi për skuadrën e Dallasis, që u mund me shifrat 110-104 nga Charlotte. Donçiqi realizoi 40 pikë e 12 rebounde, por që s'mjaftuan për të fituar. Humbet edhe ekipi kampion i



Golden States, që në fushë u mund me rezultat 99-96 nga Minnesota. Për miqtë u dallua Reid me 23 pikë, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Pooles për Warriorsin. Skuadra e Orlandos, falë një loje të mirë kolektive (8 lojtarë mbi 10 pikë), mundi 119-106

Brooklynin (Bridges 44 pikë), ndërsa Clevelandi triumfoi me shifrat 108-91 ndaj Houstonit (Allen 24 pikë e 14 rebounde). Jashtë fushës fiton ekipi i Memphisit, që mundi me shifrat 123-119 Atlantan, ndeshje ku dallimin e bënë Moranti me 27 pikë dhe Bane me 25 pikë.

REZULTATET

Charlotte - Dallas	110-104
Lakers - Chicago	108-118
Atlanta - Memphis	119-123
Boston - San Antonio	137-93
Cleveland - Houston	108-91
Orlando - Brooklyn	119-106
Toronto - Washington	114-104
Portland - Oklahoma	112-118
Golden State - Minnesota	96-99

SHKURT

Tottenhami shkarkon Conten

Tottenham Hotspuri ka njoftuar se ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Antonio Conte. Tekniku italian javë më parë akuzoi bordin e "Spurs"-it se vetëm ndryshon trajnerë, por po vazhdon të jetë pa sukses. "Mund të njoftojmë që trajneri Antonio Conte është larguar nga klubi me një marrëveshje të përbashkët. Ne arritëm kualifikimin në Ligën e Kampionëve në sezonin e parë në klub. Ne e falënderojmë Antonio për kontributin dhe i urojmë fat në të ardhmen", thuhet në njoftimin e Tottenham Hotspurit.

Cristian Stellini do të jetë trajner i përkohshëm deri në fund të sezonit.

95 mijë tifozë në 'Camp Nou' brohorasin emrin e Messit, duan rikthimin e tij

Tifozët e Barcelonës mbushën selinë historike të klubit për të parë Final 4 të Kings League të organizuar nga Gerard Pique, por me mendjen gjithmonë të Lionel Messi. Në mënyrë të veçantë, rreth 95 mijë tifozë të Barcelonës filluan të brohorasin në mënyrë ritmike emrin e argjentinasi, për të cilin skenarët e rikthimit po shtohen për sa kohë që ai nuk po rinovon kontratën me Paris Saint-Germainin. Kujtojmë se Lionel Messi nuk e ka përjashtuar mundësinë e rikthimit të tij në Katalonjë në momentin kur presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, në deklaratat e tij ka theksuar edhe një herë se numri 10 do të jetë gjithmonë i mirëpritur.

Southgate: Ndaj Ukrainës luajtëm në mënyrë të thjeshtë

Anglia pas Italisë e ka mposhtur edhe Ukrainën (2-0) dhe në këtë mënyrë dominon në Grupin C me 6 pikë. Lidhur me këtë sukses i lumtur është shprehur trajneri i "Tre Luanëve", Gareth Southgate. "Jam me të vërtetë i lumtur për paraqitjen e djemve. Ndaj Italisë e menaxhuam më mirë topin gjatë pjesës së parë, ndërsa në të dytën lejuam shumë. Këtë herë ndaj Ukrainës luajtëm në mënyrë të thjeshtë. Jam me të vërtetë i lumtur", u shpreh Southgate.

Presidenti i PSG-së: Po punojmë për t'i mbajtur Mbappen dhe Messin

Presidenti i Paris Saint-Germainit, Nasser Al-Khelaifi, ka shprehur dëshirën e tij për t'i mbajtur Kylian Mbappen dhe Lionel Messin në ekip pavarësisht prej spekulimeve të shumta për largimin e tyre. Kreu i PSG-së deklaroi se klubi nuk po kërkon të bëjë një tjetër gabim dhe t'i lërë yjet e skuadrës së tij të largohen pas eliminimit në Ligën e Kampionëve nga Bayern Muncheni. "Jemi me fat që kemi disa nga lojtarët më të mirë në botë të cilët donin të luanin për PSG-në pavarësisht se morën oferta nga klube të tjera. Ne po punojmë për t'i mbajtur ata. Ne do të analizojmë atë që po bëjmë dhe do të sigurohemi se mund të vazhdojmë me ta; ne duam t'i bëjmë gjërat në përputhje me rrethanat. Nuk do të bëjmë gabime", ka thënë Al-Khelaifi.

Rodrigues: Futbollistët e Brazilit e duan Ancelottin

Presidenti i Federatës së Futbollit të Brazilit, Ednaldo Rodrigues, konfirmoi se Carlo Ancelotti është kandidati potencial, i shumë dëshiruar nga lojtarët.

"Po, Carlo është i preferuari i lojtarëve. Duket një zgjedhje optimale. Ai gëzon besimin e plotë jo vetëm të lojtarëve, por edhe të tifozëve. Ancelotti

respektohet jo vetëm nga lojtarët aktualë në ekip, por edhe nga lojtarët e brezave të kaluar që kanë luajtur me të. Ai gëzon edhe respektin tim të singertë për vetë

punën e tij, profesionalizimin, cilësinë që gëzon. Ai është trajner i klasës botërore, që ka fituar shumë dhe kudo. Uroj të vijojë të fitojë sërish", u shpreh numri një

i futbollit brazilian, duke konfirmuar atë që flitet prej kohësh në medie. Kjo deklaratë e Rodrigues ka pushtuar faqet e para të medieve në Spanjë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Në bazë të vendimit të Komisionit të posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, datë 23 mars 2023, publikohet:

FTESË / THIRRJE PUBLIKE

për

PARAQITJEN E NOMINIMEVE PËR NJË (1) GJYQTAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 114.1 të Kushtetutës dhe me nenet 4 dhe 6, të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, fton Kuvendin e Republikës së Kosovës, institucionet gjyqësore, fakultetet juridike, Odën e Avokatëve, Shoqatën e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, partitë politike, personat e tjerë relevantë juridikë dhe individët, që të propozojnë kandidatë për zgjedhjen e një (1) gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Po ashtu, një person mund të propozojë veten për kandidat.

Komisioni në mënyrë të veçantë inkurajon gratë për të aplikuar.

Kualifikimet:

Kandidatët për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; juristë të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional, me jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë pune profesionale, veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, *mes tjerash*, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës universitarë dhe punë të tjera të rëndësishme të natyrës juridike, individë me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për ndonjë veprë penale. Të gjitha propozimeve dhe aplikacioneve për nominime, duhet t'u bashkëngjiten dokumentet si vijon:

- Formulari për nominimin e kandidatit;
- Formular të deklaramit të të nominuari;
- Curriculum Vitae (C.V) (autobiografia);
- Letra e motivimit nga organizata ose institucioni propozues;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk janë të dënuar për ndonjë veprë penale.

Nominimet dhe aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **18 prill 2023**, në orën **16:00**.

Nominimet dhe aplikacionet dërgohen personalisht në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë - Rr. "Nëna Terezë" p.n.
Drejtoria e Personelit, Zyra N-217.

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: Në shërbimin përkatës të administratës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ose forma elektronike: në ueb- faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës – www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 23. mart 2023. godine raspisuje se sledeći:

POZIV / JAVNI POZIV

za

PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA JEDNOG (1) SUDIJU
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVO

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu sa članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužilaca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor jednog (1) sudije Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

Kvalifikacije:

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda mora da budu državljani Republike Kosovo; istaknuti pravници sa odličnom profesionalnom reputacijom, ne kraćom od deset (deset) godina stručnog rada, naročito u oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, *između ostalog*, putem stručnog rada sudija, tužilaca, advokata, civilnih službenika ili univerzitetskog predavača i drugih značajnih poslova pravne prirode; lica sa odličnom moralnom reputacijom, radno sposobni, koji nisu kažnjavani za krivična dela.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije mora se priložiti sledeća dokumentacija:

- Formular nominacije kandidata
- Formular deklaracije nominiranog,
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija"),
- Preporuka organizacije ili institucije koja ga predlaže,
- Dokaz da je građanin Kosova,
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz da nisu kažnjani za krivično delo.

Nominacije i aplikacije treba da se dostave najkasnije do **18. aprila 2023. godine** u **16.00** časova.

Nominacije i aplikacije se lično dostavljaju na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština – ul."Majke Tereze", bb. Direkcija personala, Kancelarija N-217.

Aplikacije se mogu uzeti na sledećim mestima:

Formular: pri dotičnoj službi administracije Skupštine Republike Kosovo ili elektronskom poštom: web stranica Skupštine Republike Kosova - - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova na br. telefona 038 211-182, 038 211-648, i 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 23. marta 2023. godine raspisuje se sledeći:

POZIV / JAVNI POZIV

za

**PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA JEDNOG (1) SUDIJU
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVA**

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužioca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor jednog (1) sudiju Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

Kvalifikacije:

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda moraju biti državljani Republike Kosovo; istaknuti pravnici odličnog profesionalnog ugleda, sa najmanje deset (10) godina radnog iskustva, posebno iz oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, između ostalog, kroz profesionalni rad, kao: sudije, tužitelji, odvetnici, civilni službenici ili sveučilišni predavači, te druge značajne poslova pravne prirode; osobe odličnog moralnog ugleda sa punom radnom sposobnošću, koji nisu bili kažnjavani za neko krivično djelo.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije moraju se priložiti dokumenta u nastavku, i to:

- Obrazac za nominiranje kandidata
- Obrazac deklaracije nominiranog
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija");
- Pismo motivacije / preporuka predlagača - organizacije / ustanove;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu.
- Dokaz da nisu kažnjeni za krivično delo.

Nominacije i aplikacije dostaviti najkasnije do **18. aprila 2023. godine, u 16:00 sati.**

Nominacije i aplikacije dostaviti osobno na adresi:
Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majke Tereze", bb. Direkcija personala, soba br. N-217.

Aplikacije se mogu dobiti na sledećim mestima:
Štampani obrazac: u dotičnoj službi Administracije Skupštine Republike Kosovo ili elektronskom poštom: web stranica Skupštine Republike Kosova: www.assembly-kosova.org

Ostale dodatne informacije mogu se dobiti svakog radnog dana, do 16:00 sati, na telefonima: 038 211-182, 038 211-648, i 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Anayasa Mahkemesi'ne hakimlerin atanması için adaylar listesinin görüşülmesinden sorumlu Özel Komisyon'un 23 mart 2023 tarihli Kararı üzerine

**KOSOVA CUMHURİYETİ ANAYASA MAHKEMESİNE (1) BİR HAKİM
ATAMALARIYLA İLGİLİ**

ALENİ ÇAĞRI/ DAVET

Anayasanın 114.1 Maddesi ve Kosova Cumhuriyeti Anayasa Mahkemesi hakkında 03/L-121 sayılı Kanununun 4 ve 6. Maddeleri uyarınca Anayasa Mahkemesine Atama Adaylarının Gözden Geçirilmesi Özel Komisyonu, Kosova Cumhuriyeti Meclisi, yargı kurumları, hukuk fakülteleri, Avukatlar Odası, Hakimler ve Savcılar Birliği, siyasi partiler, diğer ilgili tüzel kişiler ve bireyler, Anayasa Mahkemesinin seçimi bir (1) aday için, göstermek için Kosova Cumhuriyeti'nin. Ayrıca, bir kişi bir aday için kendini aday gösterebilir.

Komisyon özellikle kadınların başvuruda bulunmalarını teşvik etmektedir.

Kalifiyeler:

Anayasa Mahkemesi hakim görevine önerilen adaylar Kosova Cumhuriyeti vatandaşı olmalı; özellikle kamu ile anayasa hukuğu alanında ve diğerleri arasında hakim, yargıç, avukat, sivil memur ya da üniversite eğitmeni olarak çalışan ve diğer önemli hukuki işlerle uğraşan en azından on (10) yıllık çalışma görgüsüne ve bununla birlikte mükemmel uzmansal ünvanına sahip ünlü hukukçular olmalı; mükemmel ahlaki ünvanına sahip olmalı ve herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmamalı.

Atamalarla ilgili tüm önerilere ve tüm formlara aşağıda saymış olacağımız şu evraklar ilave edilmelidir:

- Adayın atanmasına ait form,
- Atanan kişinin demeçte bulunmasıyla ilgili form,
- Curriculum Vitae (C.V) (özgeçmiş),
- Adayın önerildiği örgüt ya da kurum tarafından motivasyon belgesi,
- Kosova vatandaşı olduğuna dair delil,
- Öğretim ile uzmansal hazırlığına ait delil,
- Çalışma görgüsüne ait delil.
- Herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmadığına dair delil.

Atamalar ile formlar en geç **18 Nisan 2023** tarihine ve **saat 16:00**'ya kadar gönderilmelidir.

Atamalar ile formlar şahsen şu adrese gönderilmelidir:
Kosova Cumhuriyeti Meclis Binası, Priştine, "Nëna Tereza" caddesi No'suz, Personel hizmeti, Daire N-217.

Formlar şu yerlerden alınabilir:
Basılı şekli: Kosova Cumhuriyeti Meclisinin ilgili idari hizmetinde ya da elektronik şekli: Kosova Cumhuriyeti Meclisinin www.assembly-kosova.org web sayfasında.

Konuyla ilgili diğer ek bilgiler her iş günü saat 16:00'ya kadar şu telefon numaralarından alınabilir: 038 211-182, 038 211-648, ve 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR

AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 233/1

Datë: 27.03.2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/l-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së njofton:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e rishpallur me nr. 33/1 të dt. 21.01.2023 për pozitën Zëvendës Drejtor në Qendrën e Kompetencës në Prizren.

Ju njoftojmë se ky konkurs anulohet deri në një vendim tjetër.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Newco Production Plant Reçan (Prizren)" L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810513524 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Newco Production Plant Reçan (Prizren)" L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810513524 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Newco Production Plant Reçan (Prizren)" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810513524 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kroje Gjiodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Fan Noli" Dujak KK Gjakovë nga kl I-VIII.

- Naim Asllani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Shkëlqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 sh.m. profesionale "Gjon Nikollë Kazazi" Gjakovë.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Valbonë Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë Tregti.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Bujar Pozhegu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Stojkovic Jovanka shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Ekrem Rexha" Lubizhdë.

- Faton Alija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

- Amir Berisha shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Denis Saramati shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Heronjtë e Lumes" Vërmicë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

